



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI “AUDITIMIN FINANCIAR”

BASHKIA KUKËS

Tiranë 2022

 **PËRMBAJTJA**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	5
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	8
II. HYRJA	11
1. Objektivat e auditimit.....	11
2. Qëllimi i auditimit.....	11
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	12
5. Përgjegjësitë e audituesve	12
6. Kriteret e vlerësimit	12
7. Standardet e auditimit.....	13
8. Metodologjia e auditimit	13
9. Dokumentimi i auditimit.....	14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	15
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	15
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	16
2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021.....	23
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021	50
2.4 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	69
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	95
V. ANEKSET.....	105

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar me objektiv veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Bashkisë Kukës për aktivitetin ekonomik dhe financiar të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Rregulloren e procedurave të auditimit të KLSH-së, Kodin e etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Kukës si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore; auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore; mbajtjen e evidencës kontabël, etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut;
- Bashkia Kukës për periudhën objekt auditimi, klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive mbi nivelin 25 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara;
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në likuidimin e vendimeve gjyqësore, nuk ka respektuar radhën e likuidimit sipas përparësisë kohore, bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese;
- Vlera e studimeve dhe projekteve të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, përfshin edhe objekte të përfunduara, duke siguruar vlerësimin jo real të saj dhe AAJM, në vlerën 5,611,778 lekë;
- Aktivitet afatgjatë materiale të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në vlerën 1,531,017,817 lekë janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë;
- Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në vlerën 17,966,783 lekë për 484 debitorë;
- Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Kukës në datën 31.12.2021 janë në vlerën 144,992,243 lekë;
- Vlera e të ardhurave të munguara nga mos pagesa e detyrimit për kontratat e qirave është 1,628,127 lekë;
- Të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 309,830,000 lekë.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Kukës, KLSH ka dhënë “*Opinion të modifikuar*” për pasqyrat financiare.

Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative dhe rekomandime për arkëtimin e të ardhurave të munguara.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Kukës si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Kukës 5 akt konstatime dhe 1 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi projekt raportin e auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Kukës të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së procedurave të auditimit të KLSH.

Gjithashtu, në ambientet e KLSH-së u zhvillua edhe takimi përmblyës i auditimit më datë 01.09.2022.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Një auditues është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 183, datë 13.09.2019, duke qenë e pa pajisur me certifikatën e audituesit.- Nuk është planifikuar dhe nuk është kryer auditim në fushat me risk si, në sektorin IMTV-së, sektori i taksave dhe tarifave vendore, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.- Në programet dhe në procesin e auditimit të NJAB nuk konstatohet ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, e cila sjellë shkallë të ulët të zbatimit të tyre nga subjektet e audituara.- Nuk është kërkuar nga auditimi i brendshëm që subjektet e audituara, pas marrjes së rekomandimeve të hartojnë planin për zbatimin e tyre. <i>(faqe 15-23 të RPA)</i>	E lartë	Titullari i Bashkisë Kukës të marrë masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën në vazhdim të organizohet dhe të funksionojë me 3 punonjës të certifikuar, kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.
2	<p>Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 është 193,912,437 lekë, krahasuar me vlerën në fillim të vitit ushtrimor prej 158,489,871 lekë, është rritur me 35,422,566 lekë, ose në masën prej 22%.</p> <p>Edhe pse janë marrë masa të mira për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2021, konstatohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor për të gjithë periudhën e auditimit. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë detyrimet ndaj institucioneve të tjerabuxhetore në vlerën 85,867,527 lekë dhe detyrimet për investime prej 45,071,088 lekë, të ndjekura nga detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 22,417,656 lekë, detyrime për mallra në vlerën 11,020,394</p>	E lartë	Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkaku e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

	<p>lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 1,063,545 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 12,682,171 lekë, detyrime për mirëmbajtje në vlerën 6,465,584 lekë, detyrime për tatimin mbi të ardhurat në vlerën 1,274,221 lekë, të tjera 8,050,251 lekë.</p> <p>Bashkia Kukës klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive mbi nivelin prej 25 për qind (> 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara. Bashkia është klasifikuar në kategorinë me vështirësi financiare dhe kjo tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin e dytë pasues, të muajit të përcaktuar në ligj. (faqe 23-49 të RPA)</p>		
3	<p>Bashkia Kukës për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 7,043,241 lekë, nga e cila vlera 4,720,812 lekëi përket 7 vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, ndërsa vlera 2,322,429 lekë për 2 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore. Vlera e pa likuiduar e vendimeve gjyqësore më datë 31.12.2021 referuar listave analitike që administron Bashkia Kukës është 7,864,084 lekë për 18 vendime.</p> <p>Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim.</p> <p>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në likuidimin e vendimeve gjyqësore, nuk ka respektuar radhën e likuidimit sipas përparësisë kohore, bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. (faqe 23-49 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, të marrë masa që jo vetëm të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj, por edhe të hartojë grafikun e likuidimit të tyre, duke u bazuar në përparësinë e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.</p>
4	<p>Nga auditimi i analitikëvetë llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të përkasin edhe objekteve të përfunduara, duke siguruar vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 5,611,778 lekë. (faqe 50-69 të RPA)</p>	E lartë	<p>Nëpunësi Zbatues, të kryejë veprimet e sistemit për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.</p>
5	<p>Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të regjistrimit dhe pajisjes me titull pronësie të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të paraqitur 0 lekë në bilanc, në kundërshtim me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr. 8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”. (faqe 50-69 të RPA)</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshtkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. -Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të

			njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.
6	Për llogarinë 215 “Mjete transporti” rezulton se është aplikuar norma e amortizimit 20 % dhe jo 13.8%, rezultati i së cilës duhet të jetë 142,265,266 lekë dhe teprica neto 24,468,065 lekë. Kjo ka sjellë që llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM” të mbivlerësohet me 1,759,884 lekë, vlera e së cilës duhet të jetë 1,098,695,329 lekë nga 1,100,466,218 lekë. <i>(faqe 50-69 të RPA)</i>	E lartë	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”, respektivisht në vlerën 1,098,695,329 lekë për vitin 2021.
7	Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë legalizimin e banesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitet 2018-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 300 subjekte të legalizuara me vlerë 11,536,508 lekë. Për vitin 2021 janë legalizuar gjithsej 184 objekte me detyrim ndaj Bashkisë Kukës për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 6,430,275 lekë. Në totalitë ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në vlerën 17,966,783 lekë për 484 debitorë. <i>(faqe 23-49 të RPA)</i>	E lartë	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territoritë dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 484 debitorë në vlerën 17,966,783 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kukës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
8	Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Kukës rezultoi se, gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën 4,793,595 lekë dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare në shumën 3,222,231 lekë dhe detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 1,571,274 lekë. Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore më mënyrë progresive më 31.12.2021 në Bashkinë Kukës janë në vlerën 144,992,243 lekë të përbëra nga: - 9,294,922 lekë detyrime nga 2181 familje për pagesat e taksave dhe tarifave vendore; - 135,697,321 lekë detyrime nga 486 subjekte fizik/juridik. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. <i>(faqe 23-49 të RPA)</i>	E lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën: - 9,294,922 lekë detyrime nga taksat dhe tarifat familjare; - 135,697,321 lekë detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve. <i>a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.</i> <i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</i> <i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i> <i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i> e-DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
9	Nga auditimi i kontratave të qirave dhe dokumentacionit lidhur me pagesat për të gjitha kontratat rezulton se, më datë 31.12.2021 janë 5 qiramarrës (E.-SHPK & E.-Grup	E lartë	Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrin masa që qiramarrësit E. SHPK&E.-Grup SHPK,

	<p>SHPK, E.-SHPK-2 kontrata, A. Sh.A, L. & K.Energy SHPK) që nuk i kanë paguar detyrimet referuar kushteve të kontratës. Këto detyrime arrijnë në vlerën totale 4,750,643lekë. Subjektet E.-SHPK (2 kontrata) dhe L.&K. Energy kanë paguar detyrimet gjatë vitit 2022 ndërsa subjekti A Sh.A, ka lidhur marrëveshje për pagesë më këste ku ka paguar vlerën 600,000 lekë dhe i mbeten për të paguar edhe 393,333 lekë. Si rezultat vlera e të ardhurave të munguara nga mos pagesa e detyrimit për kontratat e qirave aktualisht është 1,628,127 lekë. Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave nuk disponon një regjistër të plotë dhe të përditësuar për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënien me qira të aseteve të bashkisë. Nuk janë të regjistruara saktë afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit. Për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës, veprime në kundërshtim me nenet e kontratave të qirave përkatëse. <i>(faqe 23-49 të RPA)</i></p>		<p>dhe ASh.A të paguajnë detyrimet referuar kushteve të kontratës në vlerën totale 1,628,127 lekë (E. SHPK në vlerën 1,234,794 lekë dhe A. Sh.A në vlerën 393,333 lekë). Gjithashtu, në vijimësi DAPK të ndjekë me përpikmërizbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesa referuar kushteve të kontratave. DAPK të hartojë një regjistër të plotë dhe të saktë për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënien me qira të aseteve të bashkisë. Të përditësojë saktë të dhënat mbi afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit.</p>
10	<p>Nga auditimi i dokumentacionit që administron Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Kukës lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura në rastin e konstatimit të kundërvajtjeve rezulton se, për vitin 2021 nuk janë paguar 59 gjoba me vlerë totale 25,900,000 lekë. IMTV ka bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, duke njoftuar kundërvajtësit për detyrimin që kanë, duke dërguar në gjykatë të gjitha gjobat për të bërë të mundur nxjerrjen e titullit ekzekutiv si dhe duke dërguar në përmbarrim një pjesë të gjobave, por rezulton se masat e marra kanë qenë të vonuara dhe ende nuk kanë dhënë rezultatet e duhura. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9. Në fund të vitit 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV për periudhën 2018-2021 janë në vlerën totale 309,830,000 lekë. Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30, pika 1. <i>(faqe 23-49 të RPA)</i></p>	E lartë	<p>Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale 309,830,000 lekë. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.</p>

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Konkluzioni i përgjithshëm¹:

Në përfundim të auditimit financiar të ushtruar në Bashkinë Kukës, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021, në zbatim të Programit të Auditimit 571/1 datë 13.06.2022,

¹Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, Kapitulli VII, pika 7.3.1 Angazhimet e Raportimit të Drejtpërdrejtë, me siguri të arsyeshme.

nga Kryetari i KLSH-së, Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se subjekti i audituar në përgjithësi ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, por ka konstatuar edhe disa anomali të rëndësishme por jo të përhapura të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë raport auditimi.

Nga auditimi dhe vlerësimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm konkludojmë se përgjithësisht ka probleme për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, ka përmirësime në krahasim me periudhën e mëparshme të audituar nga KLSH, në lidhje me mjedisin e kontrollit ku ushtron veprimtarinë subjekti, si dhe nuk ka kryer aktivitete kontrolli, për minimizimin e risqeve veçanërisht në menaxhimin e aktiveve. Ka nevojë për të evidentuar, monitoruar risqet e auditimit si dhe për të rritur nivelin e transparencës.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare:

KLSH auditoi pasqyrat financiare të Bashkisë Kukës, për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, vlerësimin i parimeve kontabël të përdorura si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar²

“Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar për llogaritë vjetore të vitit 2021 të subjektit Bashkia Kukës, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit”. Në llogaritë vjetore apo transaksionet të vitit 2021”, pasqyrat financiare, nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, pozitën financiare të Bashkisë Kukës në datën 31 dhjetor 2021, referuar Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore.

Baza për opinionin e modifikuar:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Kukës, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Opinionin e mësipërm të auditimit mbështetet në nivelin e materialitetit të llogaritë nga grupi i auditimit në vlerën 25,471,596 lekë, si dhe në anomali të konstatuara si më poshtë:

Përshkrimi i rasteve:

²Opinion i modifikuar jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultatit financiar.

Rastet e mospërputhshmërisë në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 Dhjetor 2021 paraqitet në si më poshtë:

Janë regjistruar në librat e kontabilitetit pa u mbështetur në dokumentacion justifikues si ai i titullit të pronësisë këto llogari:

- Llogaria 212 "Ndërtesa e Konstruksione" në vlerën 1,531,017,817 lekë

- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" është në vlerën 15,423,224 lekë dhe duhet të jetë 4,815,246 lekë;

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" është në vlerën 108,437,844 lekë dhe duhet të jetë 123,196,817 lekë;

- Llogaria 210 "Toka, Troje, Terrene" është në vlerën 70,974,458 lekë, dhe asnjë prej asetëve nuk është pajisur me titull pronësie;

-Llogaria 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" nuk ka vlerë kontabël;

-Llogaria 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM" është në vlerën 1,100,466,218 lekë dhe duhet të jetë 1,098,695,329 lekë.

Çështje të tjera: Mbi funksionimin e sistemit të kontrollit dhe auditit të brendshëm:

Bashkia Kukës, ka probleme të konsiderueshme me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe auditin e brendshëm, si dhe nuk ka bërë përmirësime krahasuar me gjetjet e auditimit të mëparshëm, në lidhje me funksionimin e sistemi i kontrollit të brendshëm. Konkretisht, në komponentin "Mjedisi i kontrollit", nuk është ngritur GMS, pozicione kyçe janë vakante, nuk është miratuar "Strategjia e Menaxhimit të Riskut. Për këto arsye, bazuar në gjykimin profesional të audituesve, funksionimi i sistemit të kontrollit u vlerësua me nivel risku të lartë, gjë që u mor në konsideratë në përcaktimin e riskut të auditimit dhe përcaktimin e testeve analitike të kryera në këtë auditim.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kukës:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kukës, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në menaxhimin e fondeve të alokuara për realizimin e objektivave funksional. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Kukës janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme³, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu, aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne

³ISA 200-ISSAI 2200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.

vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 571/1 Prot, datë 13.06.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.06.2022 deri në datën 08.07.2022, në subjektin Bashkia Kukës u krye “Auditimi Financiar” për periudhën 01.01.2021–31.12.2021. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E.V – *Audituese*
2. S. A – *Auditues*
3. K. P – *Audituese*

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Kukës ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁴;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimin të risqeve, si dhe identifikimin të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI;
- Hartimi i Raportit të Auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve, të cilat mbështeten mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Kukës është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 01.01.2021-31.12.2021, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Kukës dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

Pika 1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

⁴Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Pika 2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

Pika 3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2021.

Pika 4. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kukës, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Kukës është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Kukës. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

- Udhëzimi MFE nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Kukës grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa

e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Kukës me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale⁵.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon⁶.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e

⁵ISSAI 1315

⁶Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi nësubjektin “Bashkia Kukës”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Kukës është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

Profili i Bashkisë Kukës

Bashkia Kukës kufizohet në veri me Bashkinë Has, në perëndim me Bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë.

Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit. Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia është 47,985 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 933.86 km² me një densitet prej 63.59 banorë/km² sipas Regjistrit Civil dhe 51.38 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Bashkia Kukës përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Kukësi, Malzi, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqen, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën dhe Kolsh. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Kukës dhe pjesë e po këtij qarku.

Relievi i zonës së Kukësit është kryesisht malor në të bëjnë pjesë mali i Gjallicës dhe mali i Koritnit, pjesë të vargmalit të Korabit. Lugina e Drinit e bën territorin edhe më të ashpër gjeografikisht me grykat e thella dhe të ngushta në të cilat janë ndërtuar disa prej digave më të mëdha të hidrocentraleve. Në këtë zonë shtrihet një pjesë e liqenit të Fierzës, liqeni më i madh artificial në Shqipëri.

Qyteti i Kukësit është zonë e rëndësishme që lidh Shqipërinë me Kosovën, përmes Durrës - Morinë dhe Maqedoninë. Pavarësisht përmirësimeve që ka sjellë infrastruktura kombëtare,

relievi i vështirë i Bashkisë së Kukësit dhe problemet me infrastrukturën e brendshme të kësaj zone kanë krijuar probleme në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik.

Në qytetin e Kukësit janë të përqendruar 35% e banorëve, ndërsa pjesatjetër është e shpërndarë në 14 njësitë e tjera administrative. Njësia Administrative Bicaj ka nëterritorin e saj 10 fshatra dhe renditet e dyta për nga numri i popullsisë prej 5,631 banorësh ndërkohë qënjësia administrative më pak e populluar është Kalisi me 827 banorë dhe 5 fshatra.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

1.Mjedisi i kontrollit

- Mbi hartimin dhe miratimin e Rregullores Organizative

Për periudhën objekt auditimi 2021 Bashkia Kukës ka funksionuar me Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës e saj në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës, bazuar në Urdhër nr. 328, datë 05.04.2022. Gjithashtu Bashkia Kukës për vitin 2021 ka hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës.

- Mbi përgatitjen e gjurmës së auditimit

Për periudhën objekt auditimi, viti 2021, nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës, konkretisht në fushat me risk siç janë prokurimet me vlerë më të madhe se 1,000.000 lekë pa TVSH, prokurimet me vlerë më të vogël se 1,000,000 lekë pa TVSH, zbatimi i buxhetit, mbledhja e taksave, etj.

Me Urdhrin nr. 232, datë 06.09.2021 “Për një ndryshim në urdhrin për miratimin e gjurmës së auditit për “Administrimin e pjesëve të Këmbimit” dhe Urdhrin nr. 230, datë 26.09.2019 “Për një ndryshim në urdhrin për miratimin e gjurmës së auditit për Administrimin e Karburantit”.

Kjo sjell mos dokumentim të operacioneve të njësisë publike, në atë formë që nuk iu mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse, të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16; Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III“Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, pika 3.3. Aktivitetet e Kontrollit, Hapi “Gjurmët e auditimit”.

- Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:

Për vitin 2021, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Kukës së bashku me njësitë e varësisë, ka qenë gjithsej 710 punonjës.

Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Kukës, për periudhën e auditimit 2021 nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil. Gjatë vitit 2021, nuk janë bërë ndryshime në strukturën organizative.

Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë me Urdhrin nr. 503, datë 01.06.2022 është bërë ngritja e komisionit nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar nga detyra.

- Mbi niveline përdorimit të programeve elektronike

Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Kukës, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

2. Menaxhimi i riskut

Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitin 2021

Strategjia e menaxhimit të riskut për Bashkinë Kukës është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kukës, në bazë të Urdhrit Nr. 102, datë 10.02.2021, me kushtin e përditësimit të paktën një herë në tre vjet.

Regjistri i Riskut për vitin 2021

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është hartuar Regjistri i Riskut në nivel drejtorie për vitin 2021 dhe në nivel institucional për vitin 2022.

3. Veprimtaritë e kontrollit

Për vitin 2021, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 27, neni 8, pika b), Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) funksionon sipas Urdhrit nr. 82, datë 03.02.2021, "Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik të Bashkisë Kukës", prej 22 anëtarësh.

Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit", pika 2 dhe 8.b dhe neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues", germa "ç", GMS ka vendosur Koordinatorin e grupit të Menaxhimit Strategjik me Vendim Nr. 11, datë 03.02.2021, Znj. M O. Veprimet ekonomike bëhen mbi bazën e dokumenteve format të nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe nga Nëpunësi Zbatues.

Në bazë të udhëzimit të APP nr. 04 datë 18.06.2021 pas miratimit të buxhetit 2021, është ngarkuar në SEP regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike si dhe një kopje e tij është dërguar pranë Degës së Thesarit Kukës me shkresën nr. 144 Prot. datë 12.01.2021.

4. Informacioni dhe komunikimi

Informimi dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm. Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë Kukës, si edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun, veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 68/2017, për vitin 2021 i janë paraqitur Këshillit Bashkiak dy raporte të monitorimit të buxhetit, për 4- mujorin e parë dhe të dytë dhe po punohet për raportin e konsoliduar të vitit 2021. Këto raporte janë miratuar me VKB nr. 9, datë 24.02.2021 "Për miratimin e Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar - Dhjetor 2021, nr. 26, datë 29.06.2021 "Përmiratimin e Raportit periodik të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Prill 2021, VKB nr. 43, datë 29.09.2021 "Për miratimin e raportit periodik të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar - Gusht 2021".

5. Monitorimi

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës monitorimit në vazhdimësi, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm ose komisionet përkatëse, si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e

identifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj. Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Titulli i gjetjes 1:*Mungesa e një kuadri të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit dhe mangësi në kryerjen e detyrave specifike.*

Situata: Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit”, grupi i auditimit testoi disa nga komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm:

Mjedisi i kontrollit:Për periudhën objekt auditimi 2021 Bashkia Kukës ka funksionuar me Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës e saj në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës, bazuar në Urdhër nr. 328, datë 05.04.2022. Gjithashtu, Bashkia Kukës për vitin 2021 ka hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës.

Për periudhën objekt auditimi, viti 2021, nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës, konkretisht në fushat me risk siç janë prokurimet me vlerë më të madhe se 1,000,000 lekë pa TVSH, prokurimet me vlerë më të vogël se 1,000,000 lekë pa tvsh, zbatimi i buxhetit, mbledhja e taksave, etj.

Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:

Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Kukës, për periudhën e auditimit 2021 nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

Mbi nivelin e përdorimit të programeve elektronike:

Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Kukës, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

Kriteri:Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, pika 3.3. Aktivitetet e Kontrollit.

Ndikimi:Sjell vështirësi në përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga institucioni.

Shkaku:Mos angazhim i strukturave përkatëse në përmbushjen e detyrave që lindin në zbatim të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Kukës të merren masa për:

- Hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore;
- Krijimin e procedurave për delegimin e detyrave;
- Hartimin e gjurmëve standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Vendosjen e një sistemi elektronik të mirëfilltë unik të mbajtjes së kontabilitetit;
- Hartimin e mekanizmave të cilat t’i dedikohen ankesave për korrupsion;
- Vendosjen e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT.

Mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm

Bashkia Kukës ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e auditit të brendshëm. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryej auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në njësitë administrative dhe strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Kukës, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kartën e Auditimit, miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 72, datë 02.02.2021.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm. Kapaciteti auditues i strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Kukës, është bazuar në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar. Sektori i Auditit të Brendshëm që nga periudha e krijimit ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kukës, i përbërë nga 1 (një) drejtor dhe 2 (dy) specialistë.

Përbërja e sektorit për periudhën e auditimit paraqitet si më poshtë:

Nr.	Për vitin 2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Dt fillimi dhe mbarimi
1	SS	Drejtor/AB	I lartë ekonomik	42	8	PO	I.E.F Tiranë 40 orë	05.11.2019-aktual
2	EC	Specialiste AB	I lartë juridik	6.5	6.5	Ne proces certifikimi	S'ka	02.09.2015-16.03.2022
3	MD	Specialiste AB	I lartë ekonomik	24	2.4	JO	S'ka	13.09.2019-aktual

Nga auditimi rezultoi se:

1) Karta e Auditimit, është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Kukës me Urdhrin nr. 72, datë 02.02.2021, në përputhje me nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, ku përcaktohet se “Karta e Auditimit” është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, në të cilën përcaktohen statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm.” si dhe në përputhje me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave;

2) Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm është miratuar me urdhër të titullarit të Bashkisë nr.73, datë 02.02.2021 në përputhje me nenin 4, pika 13, të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016, për “Miratimin e manualit të auditit të brendshëm në sektorin publik”

3) Plani Strategjik është përgatitur dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhrin nr. 4968/1, datë 13.10.2020 si dhe është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2021 – 2023, me shkresën nr. 4962 Prot., datë 13.10.2020, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6.

4) Plani Strategjik është përgatitur dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhrin nr. 559, datë 07.10.2021 si dhe është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2022 – 2024, me shkresën nr. 4448 Prot., datë 07.10.2021, përpiluar në

përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6.

5) Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2021, është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëmme shkresën nr. 4962 Prot., datë 13.10.2020, i ndryshuar me shkresën nr. 4270 Prot, datë 28.09.2021, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Aditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2.

6) Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2021, dërguar me shkresën nr. 633 Prot, datë 09.02.2022, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur në përgjithësi sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.6.

7) Struktura e projekt-raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit të vëna në dispozicion për grupin e auditimit për vitin 2021 është hartuar dhe plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

8) Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike janë mbajtur e plotësuar e administruar në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të MAB, në të cilat është përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

9) Dosjet e përhershme janë çelur manualisht, veprim sipas kërkesave të MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

10) Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, rezulton se:

b) Znj. M D, me arsim të lartë, profili Ekonomi Agrare, është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 183, datë 13.09.2019, duke qenë e pa pajisur me certifikatën e audituesit. Gjatë periudhës së punës në Drejtorinë e NJAB, znj. Dogjani nuk ka paraqitur evidenca për grupin e auditimit mbi fillimin e procesit të certifikimit si "Audituese e Brendshme", veprim ky që bie në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, shkronja "c", "ç", e Ligjit nr. 114/2015, "Për Auditin e Brendshëm Publik", ku cilësohet:

c) audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm;

ç) punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si "Auditues i brendshëm", por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t'i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si "Auditues i brendshëm". Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si "Auditues i brendshëm", punonjësi i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.

Sipas planit strategjik të periudhës 2021-2023,2022-2024 i nënshtrohen auditimit të plotë: Administrata e Bashkisë, Njësitë Administrative të Bashkisë Kukës (Shtiqen, Topojan, Zapod, Shishtavec, Bicaj, Kolsh, Kalisë, Terthore, Ujmisht), saktësia e veprimeve financiare (Drejtoria e Ujësjellës dhe Kanalizime Sh.A, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit,Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Tregu agro-ushqimor, Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Kukës), prokurimet publike (Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe TI), sektori i shërbimeve (Drejtoria e arsimit parashkollor, QKF shërbimeve mbështetëse, Klubi shumë sportësh, Drejtoria e Nd. Ekonomike dhe Mb. Sociale), Policia Bashkiake Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit

Rural, Qendra Kulturore e Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, si dhe funksionimi i Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

1) Mungon identifikimi i fushave me risk në sektorin IMTV, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar, nga Përgjegjësi i NJAB, në bazë të Planit Vjetor. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhrin e ministrit të financave nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Përgjithësisht referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

2) Në programet dhe në procesin e auditimit të NJAB nuk vihet re ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, e cila sjellë shkallë të ulët të zbatimit të tyre nga subjektet e audituara. Ky rezultat shoqërohet në përmbledhjen ekzekutive të Raportit Vjetor të zbatimit të rekomandimeve të AB për vitin 2021, dërguar në MFE pranë NJQHAB me shkresën nr. 1342, datë 08.04.2021, ku nga 303 rekomandime për vitin 2021, janë zbatuar 16 rekomandime, të pa zbatuara 287 rekomandime.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se për vitin 2021 sipas planifikimit vjetor janë parashikuar për t'u kryer 16 auditime gjithsej, prej të cilave janë të realizuara 16 auditime, ku i janë nënshtruar këtij procesi, Njësitë Administrative të Bashkisë Kukës (Shtiqen, Topojan, Zapod, Shishtavec, Bicaj, Kolsh, Kalisë, Terthore, Ujmisht), Tregu agro-ushqimor, Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Kukës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Ujësjellës dhe Kanalizimeve Sh.A.

Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2021 është raportuar në mënyrë sistematike te Kryetari i Bashkisë Kukës.

Nga auditimi i raportimit vjetor 2021, konstatojmë se janë dhënë 303 rekomandime gjithsej, nga të cilat 6 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, 3 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, 224 rekomandime për masa organizative, 7 rekomandime për arkëtimin e detyrimeve të ndryshme, dhe 63 rekomandime të tjera. Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave nuk ka konfirmim zyrtar mbi masën e zbatimit të tyre.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në sektorin publik, ”Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).

Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi nuk i kanë zbatuar ato, nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, në kundërshtim me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se nga NJAB, administrohen dokumente që vërtetonin se në çdo auditim ka zbatuar programin e sigurimit të cilësisë së AB, në përputhje me Kap. VII, pika 7.1, dhe 7.1.1, të MAB.

Nga auditimi i projekt-raportit dhe raportit përfundimtar, rezulton se në procesin auditues në përgjithësi, nga audituesit e brendshëm janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe në formë.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimit që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Vend të veçantë në program zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Në përgjithësi, referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjorë në fuqi.

Nga auditimi rezulton se:

1. Mungon identifikimi i fushave me risk në sektorin IMTV, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja;
2. Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, rezulton se:
 - Emërimi i Znj. M V në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës si dhe ushtrimi i detyrës nuk ka paraqitur evidenca për grupin e auditimit mbi fillimin e procesit të certifikimit si “Audituese e Brendshme”, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, shkronja “c”, “ç”, e Ligjit nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”;
 - Subjektet e audituara nga NJAB Kukës edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi nuk i kanë zbatuar ato, nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, në kundërshtim me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:

1. Me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2;
2. Me nenin nr. 11, pika 2, shkronja “c”, e Ligjit nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”;
3. Me ligjin nr. 9720 datë 23/04/2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16/09/2010, si dhe në MAB, Kodin e Etikës dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kukës;
4. Me, nenin 11, pika 2, shkronja “c”, “ç” të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
5. Me, nenin 5, 6 e në vazhdim të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
6. Me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Hapi 11;

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Z. S. S.- Drejtor i NJAB, Z. E. C. - Specialist, auditues i NJAB dhe Znj. M. V. - Specialiste, audituese e NJAB.

Titulli i gjetjes 2: *Mosrealizim i detyrave të NjAB.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, rezulton se:

Znj. M. V., me arsim të lartë, profili ekonomi agrare, është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.183, datë 13.09.2019, duke qenë e pajisur me certifikatën e audituesit.

Mbi hartimin e planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.

1) Mungon identifikimi i fushave me risk në sektorin IMTV, sektori i taksave dhe tarifave vendore, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

Në programet dhe në procesin e auditimit të NJAB nuk vihet re ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, e cila sjellë shkallë të ulët të zbatimit të tyre nga subjektet e audituara. Ky rezultat shoqërohet në përmbledhjen ekzekutive të Raportit Vjetor të zbatimit të rekomandimeve të AB për vitin 2021, dërguar në MFE pranë NJQHAB, , ku nga 303 rekomandime për vitin 2021, janë zbatuar 16 rekomandime, të pazbatuara 287 rekomandime.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi nuk i kanë zbatuar ato, nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit.

Kriteri: Ligji nr.114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, nenin nr. 11, pika 2, shkronja “c” “ç”; MAB. Manuali i auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhrin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

Ndikimi: Nuk jep siguri të mjaftueshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni.

Shkaku: Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e ushtruara nga Auditi i Brendshëm.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Kukës të marr masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën në vazhdim të organizohet dhe të funksionojë me 3 punonjës të certifikuar, kërkesë e parashkuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Të identifikoj fushat me risk në sektorin IMTV, sektori i taksave dhe tarifave vendore, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021

Programimi i PBA 2021-2023 dhe programimi i buxhetit vjetor 2021

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdher të Kryetarit të Bashkisë Kukës, Urdher nr. 82, datë 03.02.2021, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.

Bazuar në dokumentet e paraqitura (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat administrohen nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, programet buxhetore afatmesme dhe projekt buxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Për hartimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor nga njësitet vartëse që financohen nga buxheti i Bashkisë dhe nga Drejtoritë e Bashkisë janë përgatitur kërkesat buxhetore lidhur me nevojat dhe objektivat.

Treguesit për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Kukës, për periudhën 2021-2023 janë miratuar me VKB-të si më poshtë:

- VKB nr. 169 datë 23.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/89 Prot, datë 05.01.2021, dërguar në MFE me shkresën nr. 109 Prot, datë 11.01.2021;
- VKB nr. 168, datë 23.12.2020 “Për miratimin e PBA-së për periudhën 2021-2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/92 Prot, datë 06.01.2021, dërguar në MFE me shkresën nr. 109 Prot, datë 11.01.2021;
- Relacioni i Buxhetit vjetor 2021 dhe PBA 2021-2023.

Miratimi i buxhetit vjetor për vitin 2021 është realizuar brenda afateve që janë të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Buxheti i vitit 2021 është miratuar me VKB nr. 169, datë 23.12.2020, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/89 Prot, datë 05.01.2021, dërguar në MFE me shkresën nr. 109 Prot, datë 11.01.2021. Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2021 janë planifikuar sipas buxhetit fillestar në vlerën **1,391,031 mijë lekë**, sipas tabelës në vijim. Duke marrë në konsideratë buxhetin shtesë, të ardhura në total (1,391,031 + 343,563 + 15,793)dhe shpenzime në total (1,391,031 + 359,356),janë planifikuar në vlerën **1,750,387 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer në vlerën**1,603,412 mijë lekë**.

Tabela nr. 1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2021(në mijë lekë)

Planifikimi i të ardhurave 2021				Planifikimi i shpenzimeve 2021			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë	Të ardhura	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë	Shpenzime
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	106,682			Art. 600 Paga	400,119	21,297	401,340
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2021	54,621		15,793	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	67,181	4,757	69,307
Total të ardhurat e veta	161,303			Art.602 Shpenzime operative	166,220	36,580	110,449
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.				Art. 604 Transferime korrente te brendshme	5,506	(5,032)	474
Transferta e kushtëzuar	681,472	343,563		606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	676,017	184,141	858,363
Transfertë e pakushtëzuar çelur për llogari të vitit 2021	323,448			Art. 230-231 Investime	75,988	117,613	163,479
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2021	224,808			Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	400,119	21,297	401,340
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	1,229,728						
TOTALI TE ARDHURAVE	1,391,031	343,563	15,793	TOTALI SHPENZIMEVE	1,391,031	359,356	1,603,412

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Gjatë vitit 2021, buxheti i Bashkisë Kukës ka pësuar 4 ndryshime, të cilat janë të miratuara me VKB-të e mëposhtme:

- VKB nr. 17, datë 23.04.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve në buxhetin e vitit 2021”;
- VKB nr. 33, datë 19.07.2021 “Për miratimin e një ndryshimi në buxhetin e vitit 2021”;

- VKB nr. 47, datë 29.10.2021 “Për miratimin e një ndryshimi në listën e prioriteteve të investimeve dhe në buxhetin e vitit 2021”;
- VKB nr. 74, datë 24.12.2021 “Për miratimin e një ndryshimi në buxhetin e vitit 2021”.

Të gjitha ndryshimet e buxhetit për vitin 2021 janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Kukës, respektivisht me shkresat nr.1/18 Prot., datë 28.04.2021; nr. 1/36 Prot., datë 23.07.2021; nr. 1/48 Prot., datë 08.11.2021; nr. 1/61 Prot., datë 29.12.2021. Miratimi i buxhetit vjetor për vitin 2021 është realizuar brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32.

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura. Përdorimi i të ardhurave

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021

Për vitin 2021 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **1,750,387 mijë lekë**, ndërsa realizimi në vlerën **1,603,412 mijë lekë**, ose në masën **91.6%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve operative, i cili është planifikuar në vlerën 202,800 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 110,449 mijë lekë ose në masën 54.5%.

Tabela nr. 2: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021 (në mijë lekë)

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Kukës, për vitin 2021					
Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2021	Fakti 2021	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti
Bashkia pa njësitë vartëse					
Artikulli – 600 Paga	421,416	401,340	95.2%	4,763	-
Artikulli – 601 Sig	71,938	69,307	96.3%	1,310	-
Artikulli - 602 Shpenzime operative	202,800	110,449	54.5%	35,388	-
Artikulli - 604 Transf. Korr. të brend.	474	474	100.0%		-
Artikulli - 606 Ndihma Ek. dhe PAK	860,158	858,363	99.8%		-
Artikulli - 230 Projekte	19,055	17,555	92.1%		-
Artikulli - 231 Investime	174,546	145,924	83.6%	83,954	-
Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)					-
TOTAL viti 2021	1,750,387	1,603,412	91.6%	125,415	-

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Konkluzion

Për vitin 2021 zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit 110,449 mijë lekë, paraqitet zëri i shpenzimeve operative “Artikulli 602”, realizimi është në masën **54.5%**. Zëri që ka vlerën më të lartë të realizimit 474 mijë lekë, paraqitet zëri i transfertave korrente të brendshme “Artikulli 604”, realizimi është në masën **100%**.

Tabela nr. 3: Përqindja e secilit zë të shpenzimeve faktike në shpenzimet totale për vitin 2021

Nr.	Zërat	Viti 2021	
		Vlera në % e secilit zë shpenzimi kundrejt shpenzimet totale, (përfshirë ndihmën ekonomike dhe PAK)	Vlera në % e secilit zë shpenzimi kundrejt shpenzimet totale (pa llogaritur ndihmën ekonomike dhe PAK)
1	Artikulli - 600 Paga	25%	54%

2	Artikulli - 601 Sig. Shoq + Shënd	4.3%	9.3%
3	Artikulli - 602 Shpenz. Operative	6.9%	14.8%
4	Artikulli - 604 Transf. Korr. të brend.	0.03%	0.06%
5	Artikulli - 606 Ndhma Ek. dhe PAK	53.5%	-
6	Artikulli - 230 Projekte	1.1%	2.4%
7	Artikulli - 231 Investime	9.1%	19.6%

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në Bashkinë Kukës vihet re se nuk ka një planifikim për të ardhurat që mbulojnë shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe PAK (e cila zë 53.5% të buxhetit faktik vjetor në vitin 2021). Bashkia Kukës vetëm e administron këtë proces në lidhje me plotësimin e kriterëve nga përfituesit dhe hartimin e listave. Duke marrë parasysh këtë fakt, duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK, vihet re se shpenzimet totale në vitin 2021 janë 745,049 (1,603,412 - 858,363). Bazuar në buxhetin faktik vjetor për vitin 2021, pa përfshirë ndihmën ekonomike dhe PAK, peshën specifike më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zë zëri paga që përbën 54% të totalit të shpenzimeve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që përbëjnë 9.3% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet operative që përbëjnë 14.8% dhe investimet që përbëjnë 19.6% të totalit të shpenzimeve.

Tabela nr. 4: Shpenzimet faktike sipas zërave për vitin 2021 (në mijë lekë)

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e shpenzimeve faktike në mijë lekë
		Viti 2021
1	Artikulli - 600 Paga	401,340
2	Artikulli - 601 Sig. Shoqërore & shëndetësore	69,307
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	110,449
4	Artikulli - 604 Tranferta korrente te brendshme	474
5	Artikulli - 606 (Ndhma ek. dhe PAK)	858,363
6	Artikulli - 230 Projekte	17,555
7	Artikulli - 231 Investime	145,924
TOTALI		1,603,412

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Përdorimi i të ardhurave, viti 2021

Në totalin e shpenzimeve të kryera për vitin 2021 (në vlerën 745,049 mijë lekë, pra pa llogaritur vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK), shpenzimet të cilat janë mbuluar nga të ardhurat e veta janë në vlerën 125,415 mijë lekë ose në masën 16.8% ($125,415 / 745,049 * 100$). Duke analizuar vetëm vlerën e të ardhurave të përdorura, pra drejtimi se ku janë shpenzuar të ardhurat e veta për vitin 2021 (të cilat kanë vlerën 125,415 mijë lekë), konstatohet se 28.2% e tyre është përdorur për zërin shpenzime operative ($35,388 / 125,415 * 100$), 67% në zërin investime dhe 3.8% në zërin paga dhe 1% në zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Pra vihet re se përqindjen më të lartë të shpenzimeve, nga të ardhurat e veta, e zënë investimet në masën 67% dhe përqindjen më të ulët e zënë sigurimet në masën 1%.

Raportet e monitorimit mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48 janë përgatitur raportet periodike si vijon:

- Projekt Vendim Nr. 23, datë 08.06.2021 për “Miratimin e raportit periodik të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-prill 2021” miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kukës dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak me VKB Nr. 26, datë 29.06.2021 për “Miratimin e raportit periodik të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-prill 2021”;
- Projekt Vendim Nr. 41, datë 27.09.2021 për “Miratimin e raportit të II-të periodik të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-gusht 2021” miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kukës dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak me VKB Nr. 43, datë 29.09.2021 për “Miratimin e raportit të II-të periodik të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-gusht 2021”;
- Projekt Vendim Nr. 09, datë 15.02.2022 për “Miratimin e raportit të konsoliduar të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-dhjetor 2021”; miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kukës dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak me VKB Nr. 11, datë 28.02.2022 për “Miratimin e raportit të konsoliduar të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-dhjetor 2021”; shkresa përcjellëse në MFE nr.2423/1 Prot., datë 12.04.2022.

Viti 2021 – Kryetari i Bashkisë ka miratuar “Raportin vjetor të konsoliduar të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2021” me Projekt Vendimin nr. 9, datë 15.02.2021 dhe është dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak, i cili e ka miratuar atë me VKB nr. 11, datë 28.02.2022 dhe është bërë konfirmimi nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/6 prot., datë 07.03.2022. Janë hartuar edhe dy raporte periodike për periudhën janar – prill 2021 dhe janar – gusht 2021. Raporti i konsoliduar mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2021 është përcjellë në MFE me shkresën nr. 2423/1 Prot., datë 12.04.2022.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi

Në zbatim të përcaktimeve të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, strukturat shtetërore duhet të ofrojnë asistencë në banesë ndaj shtresave në nevojë në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19. Ofrimi i asistencës konsiston në dërgimin e produkteve ushqimore e jo ushqimore minimale, barnave të rimbursueshme dhe atyre me kërkesë, për përballimin e situatës apo në kryerjen e furnizimeve me produktet e mëposhtme, për llogari të tyre. Për të bërë të mundur ofrimin e mbështetjes ndaj shtresave në nevojë, Bashkitë me kërkesën e Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës, duhet të përpilojnë listat e subjekteve përfituese. Këto lista verifikohen nga Komisioni dhe iu konfirmohen Kryetarëve të Bashkive, të cilët më pas ngrenë Komisionet e Mbrojtjes Civile dhe marrin të gjitha masat për dërgimin e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, te shtresat në nevojë.

Ndërsa, referuar përcaktimeve të VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, institucionet publike hartojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe përdorin burimet financiare të parashikuara në buxhetin vjetor si dhe rivlerësojnë buxhetin e tyre vjetor në përputhje me kryerjen e shpenzimeve shtesë të parashikuara.

Vihet re se Bashkia Kukës nuk ka parashikuar në buxhetin e vitit 2021 fonde për përballimin e gjendjes së pandemisë Covid – 19. Referuar dokumentacionit të audituar nuk janë bërë shpenzime për materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim; shërbime të tjera; uniforma dhe veshje të tjera speciale; furnizime dhe shërbime me ushqim për mencent etj.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara

Raportimi i detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vlera e këtyre detyrimeve është llogaritur nga vetë njësia vendore. Bazuar në shkresën nr. 921 Prot, datë 23.02.2022, Bashkia Kukës ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë detyrime të prapambetura në vlerën **193,912,437 lekë**, paraqitur sipas zërave në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 5: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Kukës sipas raportimit në MFE, 31.12.2021

Nr.	Emërtimi i detyrimit sipas natyrës	Vlera e detyrimit më datë 31.12.2021 (në lekë)
1	Investimet	45,071,088
2	Investime nga FZHR	0
3	TVSH dhe Kosto lokale	25,125,737
4	Mallra dhe Shërbime	36,784,540
5	Vendime Gjyqësore	1,063,545
6	Institucione buxhetore	85,867,527
Totali		193,912,437

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, bazuar në raportimin sipas shkresës përcjellëse në MFE, vihet re se detyrimet për investimet përbëjnë 23.2% të vlerës së detyrimeve totale, TVSH dhe Kosto lokale zënë 13% të vlerës së detyrimeve totale, mallra dhe shërbime zënë 19% të vlerës së detyrimeve totale, vendimet gjyqësore zënë 0.5% të vlerës së detyrimeve totale, institucionet buxhetore zënë 44.3% të vlerës së detyrimeve totale.

Rezulton se vlera e detyrimit prej 85,867,527 lekëndaj institucioneve të ndryshme shetërore është raportur në MFE por nuk është e pasqyruar në akt rakordimet me thesarin sepse rregjistrimi i këtyre detyrimeve është ende në proces rakordimi apo një pjesë janë në proces gjyqësor. Vlera e detyrimeve të rakordua me thesarin është **108,044,910 lekë** (193,912,437 - 85,867,527).

Nëse bëjmë llogaritjet me vlerën totale të detyrimit 108,044,910 lekë, pra pa llogaritur vlerën për institucionet buxhetore prej 85,867,527 lekë, vihet re se detyrimet për investimet përbëjnë 42% të vlerës së detyrimeve totale, TVSH dhe Kosto lokale zënë 23% të vlerës së detyrimeve totale, mallra dhe shërbime zënë 34% të vlerës së detyrimeve totale dhe vendimet gjyqësore zënë 1% të vlerës së detyrimeve totale prej 108,044,910 lekë.

Në bilancin e vitit 2021, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ka vlerën 107,651,976 lekë.

Në vitin 2021 nga auditimi i pasqyrave financiare, vlera e llogarisë 520 – Disponibilitete në thesar (e cila tregon fondet e pa shpenzuara gjatë vitit 2021, të cilat kalojnë për përdorim në vitin 2022), ka vlerën 261,266,228 lekë. Pra në fund të vitit 2021, njësia vendore ka trashëguar fonde të lira për vitin 2022, në një vlerë prej 153,614,252 lekë më shumë se vlera e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc (107,651,976 lekë).

Detyrimet e prapambetura sipas thesarit

Nga shqyrtimi i akt rakordimeve me Degën e Thesarit, vlerat e detyrimeve të prapambetura është **108,044,910 lekë**, të cilat paraqitentë detajuar sipas zërave paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela nr. 6: Detyrimet e prapambetura sipas akt rakordimeve me degën e thesarit Kukës

Nr.	Emërtimi i detyrimit sipas natyrës	Vlera e detyrimit më datë 31.12.2021 (në lekë)
1	Vendime Gjyqësore	1,063,545
2	Shërbime	12,682,171
3	Mirëmbajtje	6,465,584
4	Investime	45,071,088
5	Mallra	11,020,394
6	Detyrime të prapambetura të tjera	6,616,391
7	Sigurime Shoqërore	15,801,265
8	Sigurime Shëndetësore	1,274,221
9	Të ardhurat personale	8,050,251
10	Të tjera	0
11	Paga	0
Totali		108,044,910

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Të dhënat e analizuara lidhur me detyrimet e prapambetura paraqiten në tabelën përmbledhëse në vijim, referuar dokumentacionit si bilanci, akt rakordimi me degën e thesarit, raportimi në MFE dhe listat analitike që disponon Bashkia Kukës.

Tabela nr. 7: Ndryshimi i detyrimeve të prapambetura nga viti 2020 në vitin 2021

Llogaria	Emërtimi	Teprica 31.12.2020	Shtesa	Pakësime	Teprica 31.12.2021
4864100	Detyrime për Vendime Gjyqësore	3,063,545		2,000,000	1,063,545
4864200	Detyrime për Shërbime	5,067,268	7,614,903		12,682,171
4864300	Detyrime për Mirëmbajtje	28,700	6,436,884		6,465,584
4864400	Detyrime për Investime	12,992,377	32,078,711		45,071,088
4864600	Detyrime për Mallra	161,340	10,859,054		11,020,394
4864601	Detyrime për Sigurime Shoqërore	20,413,115		13,796,724	6,616,391
4864602	Detyrime për Sigurime Shëndetësore	1,399,663	14,401,602		15,801,265
4864603	Detyrime për Tatim mbi të Ardhurat Personale	13,238,184		11,963,963	1,274,221
4864604	Detyrime për Tatime të tjera	6,671,293		6,671,293	-
4864900	Detyrime Të tjera	9,586,859		1,536,608	8,050,251
TOTAL		72,622,344	71,391,154	35,968,588	108,044,910

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Në datën 31.12.2020 gjendja e detyrimeve ka qenë në vlerën **72,622,344 lekë**. Gjatë vitit 2021 janë likuiduar detyrime në vlerën **35,968,588 lekë** dhe ka pasur shtesa të detyrimeve në vlerën **71,391,154 lekë**, duke bërë që teprica e detyrimeve në 31.12.2021 të rezultojë në vlerën **108,044,910 lekë**.

Tabela nr. 8: Përmbledhje e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Kukës

Viti	Vlera e Detyrimeve sipas bilancit	Vlera e Detyrimeve sipas thesarit	Vlera e detyrimeve sipas raportimit në MFE	Vlera e detyrimeve nga dokumentet analitike
2021	108,044,910	108,044,910	193,912,437	108,044,910

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion:

Në vitin 2021 nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në shkresën përcjellëse në MFE është përfshirë në llogaritje vlera e detyrimit që Bashkia Kukës ka ndaj institucioneve buxhetore, por nuk është bërë regjistrimi në thesar për arsye se janë ende në proces rakordimi dhe një pjesë e tyre janë në proces gjyqësor. Referuar analizimit të të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme (Tabela nr. 8), rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2021 është në vlerën 193,912,437 lekë (shkresa nr. 921 Prot, datë 23.02.2022), por duke marrë parasysh faktin që vlera për institucionet buxhetore prej 85,867,527 lekë nuk është regjistruar në thesar për arsyen e përmendur më lart, në total vlera e detyrimeve i takon të jetë **108,044,910 lekë** (193,912,437 - 85,867,527).

Trajtimi i vështirësive financiare për detyrimet e prapambetura

Bashkia Kukës, përsa i takon vlerës së detyrimeve financiare për vitin 2021, klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive mbi nivelin prej 25 për qind (> 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara. Ky informacion i referohet shkresës përcjellëse në MFE, nr. 921 Prot., datë 23.02.2022, ku është paraqitur niveli i vështirësisë në të cilin pozicionohet Bashkia.

Ky klasifikim është realizuar bazuar në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, Kreu XI, neni 56, ku referuar përqindjes që ka rezultuar nga llogaritjet për vlerën e stokut të detyrimeve, Bashkia Kukës është në vështirësi financiare. Klasifikimi i Bashkisë Kukës, si njësi e vetëqeverisjes vendore në kategorinë me vështirësi financiare tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 55, të këtij ligji.

Bashkëlidhur më shkresën nr. 921 Prot., datë 23.02.2022, Bashkia Kukës ka dërguar në MFE edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Sipas këtij plani shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2022 është 35,717,090 lekë, shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2023 është 45,650,000 lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2024 është 88,569,097 lekë. Diferenca plan – fakt që paraqitet te ky plan shlyerje është në vlerën **23,976,250 lekë** [193,912,437 – (35,717,090 + 45,650,000 + 88,569,097)].

Vendimet gjyqësore për ndërprerje të kontratës së punës

Gjatë vitit 2021 janë likuiduar 7 vendime gjyqësore me vlerë **4,720,812lekë** dhe më 31.12.2021 kanë mbetur pa u likuiduaredhe **2,411,869 lekë**, që i përkasin dy vendimeve të palikuiduara plotësisht. Referuar vendimeve gjyqësore përkatëse, vendimi 20 dhe vendimi 210 deri në 31.12.2021 janë arkëtuar secili pjesërisht në masën 50% të detyrimit total të secilit vendim, konkretisht 1,671,269 lekë për vendimin 20 dhe 740,600 lekë për vendimin 210. Vlera e mbetur në datën 31.12.2021 për vendimin 20 është 1,671,269 lekë dhe për vendimin 210 është 740,600 lekë.

Duke u nisur që nga viti 2017 dhe deri në vitin 2019, sikurse paraqitet edhe në tabelën në vijim, numri i vendimeve të pa likuiduara që rezulton në datën 31.12.2021 është 5 vendime me vlerë 1,063,545 lekë. Janë likuiduar pjesërisht deri në këtë datë 2 vendime, konkretisht vendimi 529 (629), që është likuiduar për vlerën 300,000 lekë dhe vendimi 29, që është likuiduar për vlerën 362,500 lekë. Vlera totale e likuiduar deri në këtë datë, për të dyja vendimet e mësipërme, është 662,500 lekë. Për tre vendimet e tjera, konkretisht vendimi 1331, vendimi 517 dhe vendimi 81, deri në datë 31.12.2021 nuk është kryer asnjë likuidim.

Tabela nr. 9: Vendimet gjyqësore për ndërprerje të kontratës së punës, të pa likuiduara më datë 31.12.2021 (në lekë)

Nr.	Përshkrimi	Vendimi	Data	Objekti	Vlera	Likuiduar	Mbetur 31.12.2021
1	Largim nga Puna Z. K.	529(629)	20.07.2017	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	765,000	300,000	465,000
2	Largim nga Puna Xh. R.	1331	29.03.2018	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	243,000	-	243,000
3	Largim nga Puna I. M.	517	23.07.2018	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	175,000	-	175,000
4	Largim nga Puna G.Ç.	29	21.01.2019	Ndërprerje e marrëdhënieve te punës	367,045	362,500	4,545
5	Largim nga Puna N. L.	81	11.02.2019	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	176,000	-	176,000
Totali					1,726,045	662,500	1,063,545

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion:

Nisur nga raportimi që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka bërë në MFE, me shkresën nr. 921 Prot., datë 23.02.2022, lidhur me vendimet gjyqësore për zgjidhjen e kontratave të punës për vitin 2021, vlera e raportuar në 31.12.2021 është 1,063,545 lekë. Ndërkohë që bazuar në të dhënat që paraqiten në, lidhur po ashtu me vendimet gjyqësore për zgjidhjen e kontratave të punës, dy vendime (konkretisht vendimi 20 dhe vendimi 210) kanë pasur ende vlerë të palikuiduar në datën 31.12.2021, në shumën **2,411,869 lekë**. Kjo vlerë nuk është e paraqitur në shkresën në MFE, as në akt rakordimin me thesarin, por në bazë të aktmarrëveshjeve përkatëse për të dyja këto vendime, është vendosur që likuidimi të bëhet i pjesshëm. Vlera e mbetur në datën 31.12.2021 për vendimin 20 është 1,671,269 lekë dhe për vendimin 210 është 740,600 lekë.

Nga analizimi i informacionit, përsa i takon përparësisë kohore të likuidimit të vendimeve gjyqësore, të paraqitur në, bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, vihet re se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8.

Vendime të tjera gjyqësore

Nga shqyrtimi i listave analitike të detyrimeve të prapambetura për periudhën objekt auditimi rezultojnë 2 vendime të tjera gjyqësore, që janë likuiduar plotësisht gjatë vitit 2021 nga Bashkia Kukës, në vlerën **2,322,429 lekë**. Sipas aktmarrëveshjes për vendimin 193(208), likuidimi është realizuar vetëm për vlerën 322,429 lekë, pa marrë në konsideratë gjobat/kamat vonesat. Gjatë vitit 2021 nuk është likuiduar asnjë nga 6 vendimet që paraqiten në tabelën më poshtë (Tabela nr. 10), duke rezultuar kështu që në datën 31.12.2021 vlera e mbetur pa u likuiduar të jetë **4,388,670 lekë**.

Tabela nr. 10: Detyrimet e prapambetura nga vendime gjyqësore të tjera për vitin 2021 (në lekë)

Nr.	Përshkrimi	Vendimi	Data	Objekti	Vlera	Likuiduar	Mbetur 31.12.2021
1	Largim nga Puna S. S.	312(247)	04.05.2016	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	798,560	-	798,560

2	Largim nga Puna D. B.	298	04.12.2020	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	760,000	-	760,000
3	Largim nga Puna I. D.	1295	28.12.2020	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	928,120	-	928,120
4	Largim nga Puna Sh. Sh.	260	25.03.2021	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	826,000	-	826,000
5	Largim nga Puna Y. Sh.	(1047)153	27.10.2020	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	556,950	-	556,950
6	Largim nga Puna L. S.	405	15.11.2021	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	519,040	-	519,040
Totali					4,388,670	-	4,388,670

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion:

Përsa i takon vendimeve të tjera gjyqësore, për gjashtë vendimet e paraqitura në tabelën e mësipërme (Tabela nr. 10) nuk është kryer asnjë likuidim deri në datën 31.12.2021, duke rezultuar kështu që vlera e mbetur për vitin në vijim për këto vendime të jetë 4,388,670 lekë.

Faturat e palikuiduara për vitin 2021

Nga dokumentet e analizuara, të paraqitura nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, për vitin 2021 rezultojnë pa u likuiduar deri në datën 31.12.2021, 9 fatura të pa likuiduara për shërbime në vlerën **1,311,391 lekë**, 1 faturë e palikuiduar për investime në vlerën **26,000 lekë** dhe 15 fatura të tjera të palikuiduara në vlerën **7,053,720 lekë**, ndërsa fatura të palikuiduara për mirëmbajtje nuk ka.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre
Nga analizimi i të dhënave për periudhën e auditimit, për vitin 2021, Bashkia Kukës nuk ka realizuar asnjë projekt me investime të financuara nga FZHR dhe vetë ajo.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Financës në Bashkinë Kukës, z. M. I.

Titulli i Gjetjes 3: *Bashkia Kukës për periudhën objekt auditimi, klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive mbi nivelin 25 % të shpenzimeve vjetore të miratuara.*

Situata: Në vitin 2021 nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në shkresën përcjellëse në MFE është përfshirë në llogaritje vlera e detyrimit që Bashkia Kukës ka ndaj institucioneve buxhetore, por nuk është bërë regjistrimi në thesar për arsye se janë ende në proces rakordimi dhe një pjesë e tyre janë në proces gjyqësor. Referuar analizimit të të dhënave bazuar në shkresën nr. 921 Prot, datë 23.02.2022, rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2021 është në vlerën 193,912,437 lekë, por duke marrë parasysh faktin që vlera për institucionet buxhetore prej 85,867,527 lekë nuk është regjistruar në thesar për arsyen e përmendur më lart, në total vlera e detyrimeve i takon të jetë 108,044,910 lekë (193,912,437 - 85,867,527). Përsa i takon vlerës së detyrimeve financiare për vitin 2021, Bashkia Kukës klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive mbi nivelin prej 25 për qind (> 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara, referuar shkresës përcjellëse në MFE. Bashkia është klasifikuar në kategorinë me vështirësi financiare dhe kjo tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin e dytë pasues, të muajit të përcaktuar në ligj. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës ka dërguar në MFE edhe planin e shlyerjes së stokut

të detyrimeve për tre vitet në vazhdim, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Sipas këtij plani shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2022 është 35,717,090 lekë, shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2023 është 45,650,000 lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2024 është 88,569,097 lekë.

Gjithashtu, përsa i takon faturave të palikuiduara rezultojnë 9 fatura të palikuiduara për shërbime në vlerën 1,311,391 lekë, 1 faturë e palikuiduar për investime në vlerën 26,000 lekë dhe 15 fatura të tjera të palikuiduara në vlerën 7,053,720 lekë, ndërsa fatura të palikuiduara për mirëmbajtje nuk ka.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 56, pika 1.

Ndikimi: Identifikimi dhe vlerësimi në kohë i gjendjes së situatës financiare, në të cilën gjendet Bashkia Kukës, ndikon në marrjen e masave dhe hartimin e planeve të duhura të likuidimit të detyrimeve, për të ndihmuar në tejkalimin sa më shpejt të vështirësisë financiare.

Shkaku: Vonesat në likuidimin e detyrimeve ndaj palëve të treta për një kohë më të gjatë se afati i përcaktuar, masa shumë më e lartë që zënë detyrimet e konstatuara si të papaguara krahasuar me masën e përcaktuar në ligjin përkatës dhe mos realizimi në kohë i rakordimeve për regjistrimet në thesar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejnë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Titulli i Gjetjes 4: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në likuidimin e vendimeve gjyqësore, nuk ka respektuar radhën e likuidimit sipas përparësisë kohore, bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese.*

Situata: Është shlyer pjesërisht vendimi 529 (629), në vlerën 300,000 lekë, që i përket periudhës 20.07.2017 dhe në datën 31.12.2021 rezulton me vlerë të mbetur 465,000 lekë. Është shlyer pjesërisht vendimi 29, në vlerën 362,500 lekë, që i përket periudhës 21.01.2019 dhe në datën 31.12.2021 rezulton me vlerë të mbetur 4,545 lekë. Ndërkohë që për vendimet 1331 dhe 517, që i përkasin respektivisht periudhave 29.03.2018 dhe 23.07.2018, ende nuk është kryer asnjë likuidim, duke bërë që vlera e mbetur në 31.12.2021 të jetë 243,000 lekë për vendimin 1331 dhe 175,000 lekë për vendimin 517. Pra siç mund të shihet qartë, ka nisur likuidimi i vendimit 29 që i përket vitit 2019, pa u likuiduar fillimisht vendimet e vitit 2018 dhe 2017 (plotësisht). Nga ana tjetër, përsa i takon vendimeve gjyqësore të tjera, nuk është marrë ende asnjë masë për të filluar të likuidohet vendimi 312(247), që i përket periudhës 04.05.2016, në vlerën 798,560 lekë. Nga analizimi i informacionit, përsa i takon përparësisë kohore të likuidimit të vendimeve gjyqësore, të paraqitur në Tabelën nr. 9 dhe, bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, vihet re se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese.

Kriteri: Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8.

Ndikimi: Identifikimi dhe likuidimi i detyrimeve të vendimeve gjyqësore, sipas radhës së paraqitjes në njësinë shpenzuese, ndikon në vlerësimin e situatës financiare të Bashkisë Kukës, përse i përket detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka respektuar përparësinë e likuidimit të vendimeve gjyqësore të paraqitura pranë saj.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, të marrë masa që jo vetëm të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj, por edhe të hartojë grafikun e likuidimit të tyre, duke u bazuar në përparësinë e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Titulli i Gjetjes 5: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, nuk ka raportuar në MFE dhe në akt rakordimin me thesarin, vlerën e saktë të vendimeve gjyqësore të palikuiduara deri në datën 31.12.2021.*

Situata: Vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2021 është 193,912,437 lekë, ndërsa vlera totale e detyrimeve të prapambetura sipas akt rakordimeve me thesarin është 108,044,910 lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihet vlera prej 85,867,527 lekë që i përket detyrimit për institucionet buxhetore. Gjithashtu, Bashkia Kukës nuk ka deklaruar në raportimin e bërë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë vlerën e plotë të vendimeve gjyqësore. Vlera e deklaruar është 1,063,545 lekë ndërsa vlera sipas listave analitike është 7,864,084 lekë. Një pjesë e vendimeve gjyqësore nuk janë delkaruar si detyrime sepse Bashkia Kukës ka nënshkruar marrëveshje për likuidimin me këste të detyrimit dhe një pjesë nuk janë rregjistruar sepse janë paraqitur me vonë në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Ndërkohë që bazuar në të dhënat që paraqiten, lidhur po ashtu me vendimet gjyqësore për zgjidhjen e kontratave të punës, dy vendime (konkretisht vendimi 20 dhe vendimi 210) kanë pasur ende vlerë të palikuiduar në datën 31.12.2021, në shumën 2,411,869 lekë. Kjo vlerë nuk është e paraqitur në shkresën në MFE, as në akt rakordimin me thesarin, por në bazë të aktmarrëveshjeve përkatëse për të dyja këto vendime, është vendosur që likuidimi të bëhet i pjesshëm. Vlera e mbetur në datën 31.12.2021 për vendimin 20 është 1,671,269 lekë dhe për vendimin 210 është 740,600 lekë.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”.

Ndikimi: Identifikimi i vlerës së plotë të të gjitha detyrimeve që kanë mbetur pa u likuiduar, ndikon në vlerësimin e situatës financiare të Bashkisë Kukës.

Shkaku: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka regjistruar vlerën e plotë të detyrimeve në fund të vitit 2021.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në raportimin që dërgon në MFE dhe në akt rakordimin me thesarin, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të të gjitha detyrimeve që kanë mbetur pa u likuiduar në fund të viti, me qëllim identifikimin e vlerës reale të detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të pa likuiduara.

Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre dhe borxhi tatimor.
Struktura e Bashkisë Kukës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2021, Struktura organizative e Bashkisë Kukës është miratuar me Vendimin e Kryetarit, nr. 01, datë 07.01.2021 “Për miratimin e strukturës organike, kategorive/klasës së pagave të administratës së Bashkisë Kukës”;

Në strukturën e Bashkisë Kukës për vitin 2021 Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave (DAPPLL) ka patur 12 punonjës në total.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Titulli i gjetjes 6: Mbi planifikimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës.

Situata: Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Kukës është miratuar me VKB-në nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/93 Prot, datë 06.01.2021.

Tabela nr.11: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Kukës, për vitin 2021

Nr.	Përshkrimi	Plan	Fakt	Ralizi mi %
I	Të Ardhurat Tatimore	54,108,800	79,113,131	146
1	Taksa e ndërtesës	9,183,286	15,964,670	174
2	Taksa e tokës bujqësore	568,328	9,602	2
3	Taksa e Truallit	1,721,866	1,183,374	69
4	Taksë mbi biznesin e vogël	4,362,061	3,260,160	75
5	Taksë e ndikimit ne infrastrukturë	5,740,117	2,426,279	42
6	Taksë për fjetjen në hotel	344,373	84,566	25
7	Taksa e automjeteve DRSHTRR	10,331,197	24,950,760	242
8	Taksë mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	229,582	77,804	34
9	Taksa për tabelën	3,099,359	829,916	27
10	Taksa për reklamat	3,099,359	1,917,000	62
11	Taksa vendore e përkohshme (HEC-e+Miniera)	12,559,494	28,374,000	226
12	Taksa të tjera (MZSH)	2,869,777	35,000	1
II	Të Ardhurat Jotimore	5,705,117	31,868,243	559
1	Të ardhurat nga menaxhimi i asetëve	803,538	5,626,553	700
2	Të ardhurat nga qiratë	286,978	1,318,000	459
3	Të tjera Gjobat, IMTV, policia etj.	344,373	365,718	106
4	Kamatë Vonesa	344,373	1,402,831	407
5	Të ardhura të tjera debitorë (sekuestrime zhdëmtime)	482,123	9,408,408	1,951
6	Të ardhura të tjera (24 orësh+linje tensioni+renta minerare)	3,443,732	1,382,028	40
7	Tatim mbi të ardhurat personale		12,364,705	
III	Të Ardhurat nga Tarifat etj.	46,867,509	34,522,347	74

1	Tarifë pastrimi	14,348,885	19,250,398	134
2	Tarifë gjelbërimi	2,869,777	2,342,648	82
3	Tarifa e ndriçimit	1,836,657	2,014,586	110
4	Tarifa e zënies së hapësirës publike	573,955	810,361	141
5	Tarifae lejes së transportit, Certifikatë, Autorizim	1,147,911	1,227,973	107
6	Tarifa e parkimit	585,434	338,784	58
7	Tarifa e administrimit (Urbanistika)	11,479,108	951,577	8
8	Tarifa e Ushqimit Kopshtet	5,073,766	5,585,152	110
9	Tarifa e Ushqimit Çerdhet	1,377,493	1,384,630	101
10	Tarifa e Ushqimit Konvikti	688,746	272,338	40
11	Tarifa (bileta tregu dhe pallati kulturës,etj)	229,582	0	0
12	Tarifa për shërbime (tregu, fatura dritash)	2,869,777	143,900	5
13	Tarifa e përkohshme për investime në bashki	3,443,732	200,000	6
14	Tarifa e Shërbimit Veterinar	342,685	0	0
	TOTALI	106,681,425	145,503,721	136

Burimi: DAPPLL, Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Bazuar në të dhënat e paraqitura në Tabelën nr. 11 vërehet se në Bashkinë Kukës të ardhurat paraqiten me tejkalim të planifikimit për periudhën në auditim. Përkatësisht, kemi tejkalim në vlerën 38,822,296 lekë ose janë realizuar në masën **136%** nga 106,681,425 lekë të planifikuara janë realizuar 145,503,721 lekë.

Nga auditimi rezulton se, DAPPLL pavarësisht kërkesave që ka dërguar në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2021 nuk ka marrë informacion ose ai ka qenë jo i plotë. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAPPLL për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për problemet e cituara më sipër në metodologjinë e planifikimit dhe realizimit të taksave dhe tarifave vendore janë z. Sh. D. me detyrë Drejtor i DAPPLL dhe z. V. G. me detyrë Shef i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Kriteri: Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”.

Ndikimi: Niveli i planifikimit të të ardhurave të bashkisë nga taksat dhe tarifave vendore ndikon direkt në hartimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Kukës.

Shkaku: Strukturat brenda Bashkisë Kukës si dhe institucionet në varësi nuk dërgojnë informacionin përkatës pranë DAPPLLsipas përcaktimeve të VKB-së për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Kukës. DAPPLLnga ana e saj në mungesë të këtij informacioni si dhe nga mos kryerja e analizave të mirëfillta nuk arrin një planifikim efektiv.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Taksa mbi tokën bujqësore

Titulli i gjetjes 7:*Mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore.*

Situata: Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23⁷ të VKB-së nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021” dhe është e ndarë në 10 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit.

Sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Kukës në klasifikimin sipas rretheve klasifikohet në nivelin e katërt ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.12: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Referuar këtij klasifikimi, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nën kategorizime.⁸ Ajo që vihet re në VKB-në për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës është se kategorizimi i tokës bujqësore është miratuar siç e ka klasifikuar ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe nuk janë miratuar nën kategorizime, që nënkupton klasifikimin e tokës bujqësore të njëjësive të ndryshme administrative brenda kategorizimit të ligjit. Në Bashkinë Kukës 12 njësi administrative janë klasifikuar në kategorinë e VII-X, që do të thotë vlera e taksës lekë/ha/vit është 700 lekë dhe 2 njësi administrative janë klasifikuar në kategorinë e VI-të, vlera e taksës lekë/ha/vit është 800 lekë. Në vijim paraqitet pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës.

Tabela nr. 13: Inventari i tokës bujqësore që disponon Bashkia Kukës, dhe ndarja e saj sipas familjeve

Nr.	Njësia Administrative	Nr. i familjeve gjithsej që kanë tokë me AMTP	Sipërfaqe në pronësi të bashkisë (ha)	Tokë e marrë me AMTP (ha)	Çmimi sipas paketës fiskale lekë/ha	Detyrim vjetor/lekë
1	NjA Bushtricë	688	567	212	700	148,400
2	NjA Kalis	559	560	148	700	103,600
3	NjA Gryk-Çaje	452	465	193	700	135,100
4	NjA Bicaj	1595	707	358	800	286,400
5	NjA Shishtavec	990	1343	573	700	401,100

⁷ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2.

⁸ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1.

6	NjA Zapod	630	319	196	700	137,200
7	NjA Ujmisht	904	634	188	700	131,600
8	NjA Topojan	855	527	303	700	212,100
9	NjA Tërthore	889	695	180	800	144,000
10	NjA Malzi	1418	521	310	700	217,000
11	NjA Kolsh	339	393	119	700	83,300
12	NjA Arren	472	99	122	700	85,400
13	NjA Surroj	582	236	133	700	93,100
14	NjA Shtiqen	337	540	275	700	192,500
15	NjA Kukës		447			
Shuma		10,710	8,053	3,310		2,370,800

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi rezulton se, referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës paraqiten në vlerën 2,370,800 lekë, ndërsa planifikimi i bërë nga DAPPLL për vitin 2021 është në vlerën 568,328 lekë. Diferenca në planifikim është 1,802,472 lekë. Gjithashtu, rezulton se, Bashkia Kukës ka filluar punën për të saktësuar numrin e familjeve që kanë tokë bujqësore me AMTP si dhe kategoritë që përjashtohen nga pagesa e kësaj takse me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota për të llogaritur më pas saktësisht planifikimin e të ardhurave nga toka bujqësore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. SH.D. me detyrë Drejtor i DAPPLL dhe z. V. G.me detyrë Shef i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1. VKB nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”.

Ndikimi: Mos planifikim i saktë i të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, rezulton në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit efektiv midis DAPPLL dhe Drejtorisë së Bujqësisë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën **1,802,472lekë**.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Titulli i gjetjes 8: *Mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.*

Situata: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike,

drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësisë të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Në Bashkinë Kukës struktura që administron dokumentacionin dhe përlogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi i ecures së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, që nga viti 2018 deri në fundin e vitit 2020 në territorin e Bashkisë Kukës janë legalizuar 450 objekte me vlerë totale për t'u paguar 16,392,315 lekë. Në vijimësi kanë paguar detyrimin 150 qytetarë në vlerën 4,885,807 lekë dhe janë ende debitor ndaj bashkisë 300 qytetarë me vlerë 11,536,508 lekë, paraqitur më e detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr.14: Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2018-2020

Viti	Numri total i legalizimeve	Detyrimi financiar në lekë	Numri i faturave të paguara	Vlera në lekë	Numri i faturave të pa paguara	Vlera në lekë
2018	264	9,017,906	81	2,148,132	183	6,869,774
2019	140	5,317,263	46	1,880,361	94	3,436,902
2020	46	2,057,146	23	827,314	23	1,229,832
2021	184	6,430,275	0	0	184	6,430,275
SHUMA	450	16,392,315	150	4,885,807	484	17,966,783

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, **për vitet 2018-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 300 subjekte të legalizuara me vlerë 11,536,508 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës.**

Grupi i auditimit konstatoi se DPKZHT ka filluar të koordinojë punën me DAPPLL duke dërguar informacion pranë Drejtorisë së të Ardhurave me qëllim që të bëhet regjistrimi i detyrimeve që subjektet/familjet që kanë përfituar legalizimin kanë ndaj bashkisë. DAPPLL ka njoftuar të gjithë debitorët e mbartur ndër vite dhe është në proces të ndjekjes së pagesave të kësaj takse. Me gjithë përpjekjet e bëra deri më tani për të rritur nivelet e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pagesa e kësaj takse nga qytetarët vijon të jetë në vlera shumë të ulta.

Për vitin 2021 janë legalizuar gjithsej **184 objekte** për të cilat DPKZHT ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën **6,430,275** lekë. Nga auditimi rezulton se, gjatë vitit 2021 nga ASHK nuk është dërguar informacion në Bashkinë Kukës lidhur me objektet e legalizuara. Bashkia Kukës nga ana e saj ka dërguar në ASHK shkresën nr. 5450 Prot., datë 26.11.2021 ku ka kërkuar që nga ASHK t'i dërgohet lista e objekteve të legalizuara sipas të dhënave të nevojshme. ASHK nga ana e saj ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2778/1 Prot., datë 09.12.2021 duke dërguar listën e objekteve të legalizuara deri në shtator 2021, ndërsa me shkresën nr. 1313/1 Prot., datë 08.06.2022 ka dërguar listën e objekteve të legalizuara në vijim.

DPKZHT nga ana e saj ka bërë llogaritjen e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë që lind në momentin që objektet legalizohen. Kjo llogaritje është bërë gjatë 6-mujorit të I-rë të vitit 2022 dhe si rezultat nuk ka ende pagesa të kryera lidhur me këtë detyrim nga qytetarët që kanë legalizuar objektet.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për sa më sipër janë z. A. Sh. me detyrë Drejtor i DPKZHT dhe z. Sh. D. me detyrë Drejtor i DAPPLL.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”.

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimit të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim” pika 5.

VKB nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës, nga mos arkëtimi i vlerës prej **17,966,783 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e masave efektive nga strukturat e Bashkisë Kukës të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territoritë dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 484 debitorë në vlerën 17,966,783 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kukës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Kukës:

Tabela nr. 15: Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Kukës viti 2021

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja 31.12.2021
1	Biznesi Vogël	2021	543	78	28	593
2	Biznesi Madh	2021	147	2	3	146
	Gjithsej	2021	690	80	31	739

Burimi: Bashkia Kukës

Sikurse është paraqitur edhe në tabelën më sipër, në Bashkinë Kukës numri i bizneseve të vogla që janë regjistruar për të ushtuar aktivitet ka ardhur duke u rritur.

Taksat dhe tarifat për familjarët

Në Bashkinë Kukës familjet ngarkohen për taksat e ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore si dhe për tarifën e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit.

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura lidhur me familjet debitorë, rezulton se në fund të vitit 2020 numri i familjeve debitorë në Bashkinë Kukës është 1810 me vlerë totale detyrimi 6,072,691 lekë. Detyrimin në fund të vitit 2020 i shtohet dhe detyrimi i krijuar për vitin 2021 në vlerën 3,222,231 lekë duke sjellë që vlera e detyrimeve nga taksat dhe tarifat familjare në Bashkinë Kukës më datë 31.12.2021 të arrijë në vlerën 9,294,922 lekë. Nga shqyrtimi i të dhënave dhe materialeve të paraqitura rezulton se Bashkia Kukës - DAPPLL, vetëm llogarit

detyrimet e familjeve por nuk i njofton për detyrimet që ato kanë ndaj bashkisë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 84, datë 17.07.2014, neni 8, ndryshim i nenit 69⁹. Gjithashtu, Bashkia Kukës nuk bashkëpunon me agjent tatimor për të rritur vjeljen e taksave dhe tarifave vendore familjare.

Menaxhimi i borxhit

Titulli i gjetjes 9: Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Kukës dhe masat e marra për uljen e tij.

Situata:

Tabela nr. 16: Bizneset Debitorë 2020-2021

Nr.	Njësitë Administrative	Detyrimi 31.12.2020		Detyrimi 31.12.2021	
		Nr.Bizneseve	Detyrimi	Nr.Bizneseve	Detyrimi
1	NjA Bushtricë	1	20,129	1	10,312,470
2	NjA Kalis	3	355,039	0	0
3	NjA Gryk-Çaje	0	0	0	0
4	NjA Bicaj	4	120,759	3	138,743
5	NjA Shishtavec	1	16,344	1	33,224
6	NjA Zapod	2	255,336	1	1,380,356
7	NjA Ujmisht	3	3,138,093	1	4,147,535
8	NjA Topojan	4	111,153	4	60,982
9	NjA Tërthore	5	841,712	5	495,448
10	NjA Malzi	3	174,901	4	153,297
11	NjA Kolsh	7	7,412,096	5	14,150,844
12	NjA Arren	0	0	0	0
13	NjA Surroj	11	10,406,543	9	11,479,356
14	NjA Shtiqen	1	15,726	1	15,726
15	NjA Kukës	467	81,233,426	451	93,329,340
	Totali	512	104,101,257	486	135,697,321

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr. 17: Familjet Debitorë

Viti	Numri i familjeve debitorëve	Shuma (në lekë)
31.12.2020	1810	6,072,691
31.12.2021	2181	9,294,922

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Vlera totale e borxhit tatimor që menaxhohet nga DAPLL paraqitet:

Vlera e borxhit tatimor më datë 31.12.2020

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat familjare në shumën 6,072,691 lekë (1810 familje);

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve në shumën 104,101,257 lekë (512 subjekte);

Borxh i krijuar gjatë vitit 2021

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat familjare në shumën 3,222,231 lekë;

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve në shumën 1,571,274 lekë (123 subjekte);

Vlera e borxhit tatimor më datë 31.12.2021

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat familjare në shumën 9,294,922 lekë (2181 familje);

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve në shumën 135,697,321 lekë (486 subjekte);

⁹ Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor:

a) në rrugë elektronike..., b) nëpërmjet shërbimit postar rekomandë.

Detyrime nga familjet për pagesat e taksave dhe tarifave vendore më 31.12.2021 është në shumën **9,294,922 lekë për 2181 familje**.

Referuar informacionit të paraqitur nga DAPPLL Bashkia Kukës, u konstatua se në fund të vitit 2021 gjendja e debitorëve progresiv vetëm për subjektet fizik/juridik është **135,697,321 lekë për 486 subjekte**. DAPPLL me shkresën nr. 367 Prot, datë 31.03.2022 ka dërguar listën e subjekteve debitore për vitin 2021 pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi lidhur me ndjekjen e debitorëve dhe likuidimin e detyrimeve nga ana e tyre janë, z. Sh. D. me detyrë Drejtori i DAPPLL dhe z. P. G. me detyrë Shef i Sektorit të Borxhit.

Masat e marra nga DAPPLL për arkëtimin e detyrimeve

Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Kukës është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:¹⁰

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DAPPLL lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, DAPPLL ka njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifave vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, DAPPLL ka nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar 13 bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorë.

Si rezultat i këtyre masave të marra nga ana e DAPPLL nga debitorët që rezultonin në fund të vitit 2020 gjatë vitit 2021 kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë **138 subjekte me vlerë 8,804,874 lekë**.

Për debitorët e vitit 2021 Bashkia Kukës gjithashtu, ka filluar marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve 83 subjekte me vlerë **21,654,259 lekë**.

Konstatohet se, pavarësisht masave të marra nga strukturat e Bashkisë Kukës niveli i borxhit tatimor në fund të vitit 2021 ka pësuar një ulje në numër subjektsh debitore dhe një rritje në vlerën totale të borxhit nga viti 2020 në vitin 2021.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

¹⁰ Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89,90,91,93.

Rekomandim:Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **9,294,922 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifave familjare;

- **135,697,321 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifave e bizneseve.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Titulli i gjetjes 10: Mbi pagesën e autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse.

Situata:Në territorin e Bashkisë Kukës për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 16 subjekte në 18 adresa.

Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi¹¹.

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve hidrokarbure dhe i dokumentacionit të paraqitur nga strukturat e Bashkisë Kukës lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit rezulton se për vitin 2021, strukturat e Bashkisë Kukës nuk kanë dokumentacion të plotë për të gjitha subjektet. Përkatësisht, nuk kanë autorizimet për çdo subjekt për të llogaritur afatet me qëllim rinovimin e tyre në kohë. Në fund të vitit 2021, nga 18 adresa që tregtojnë lëndë djegëse me pakicë, strukturat e Bashkisë Kukës disponojnë autorizimet vetëm për 8 adresa. Për 10 adresat e tjera bashkia nuk ka asnjë informacion nëse këto subjekte janë pajisur me autorizimet e duhura dhe kur janë afatet e rinovimit të tyre.

Tabela nr. 18: Përmbledhje mbi subjektet hidrokarbure, pajisja me autorizimin përkatës dhe pagesat e taksave dhe tarifave vendore

Nr.	Subjekti	Adresa	Autorizime bazë	Autorizime të reja	Pagesa e Autorizimit (lekë)	Shënime
1	K. Advertising			24.02.2022- 23.02.2023	200,000	
2	"V.B.N." Sh.p.k	Komuna Thertore	30.03.2015- 30.03.2020	29.03.2022- 28.03.2023	200,000	

¹¹Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

3	G. Petrol	L.nr.3				Aktiv Sipas QKB
4	G. Center	Rr. Prizrenit	15.01.2020- 15.01.2021	01.02.2022- 31.01.2027	200,000	
5	U. C.	Rr. Mehmet H.Brruti	17.07.2020- 17.07.2021	02.02.2022- 01.02.2023	200,000	
6	U. C.	Rr. e Dëshmorëve	14.07.2020- 14.07.2021	28.02.2022- 27.02.2023	200,000	
7	B. Petrol Sh.p.k	L. nr.3		09.03.2022- 08.03.2023	200,000	
8	V. Sh.	Rr. e Prizrenit				Aktiv Sipas QKB
9	D. Oil	Rr. Kukës-Prizren	17.01.2019- 17.01.2020	22.06.2022- 21.06.2023	200,000	
10	P. N.	Fshati Bardhoc	02.07.2019- 01.07.2024		1,000,000	
11	N. Sh.p.k	Gjegjan		15.02.2022- 14.02.2023	200,000	
12	S. P. Albania	Rr. e Prizrenit				Aktiv Sipas QKB
13	E. Oil-2017 Sh.p.k	Fshati Bardhoc	08.05.2020- 08.05.2021	21.02.2022- 20.02.2023	200,000	
14	B. Sh.p.k	L.nr. 1		03.03.2022- 02.03.2023	200,000	
15	B. Sh.p.k	L.nr. 2		03.03.2022- 02.03.2023	200,000	
16	K. Sh.p.k	L.nr. 3	24.04.2020- 24.04.2025		1,000,000	
17	D. 2001 Sh.p.k	Kolsh				Aktiv Sipas QKB
18	G.P. Shpk	Lagjia nr.3		23.03.2022- 22.03.2022	200,000	

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2022 ka filluar pajisja me autorizime e subjekteve hidrokarbure ku janë pajisur 12 subjekte ndërsa 4 subjekte (G. Petrol, V. Sh., S. P. Albania, D. 2001 SHPK) ende ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Ushtimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”. Neni 20-Autorizimet pika 2. “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë

veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11¹², jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje”.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për problematikat e trajtuara më sipër në pajisjen me autorizim të subjekteve hidrokarbure janë, z. Sh. D. me detyrë Drejtor i DAPPLL dhe z. K. E. me detyrë Specialist për dhënien e licencave dhe autorizimeve.

Kriteri: Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës.

Shkaku: Puna jo efektive e DAPPLL në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetet pa autorizim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet G. Petrol, V.Sh., S.P. Albania, D. 2001 SHPK që ushtrojnë aktivitetet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Subjektet që ushtrojnë aktivitetet në fushën e minierave

Në Bashkinë Kukës ushtrojnë aktivitetet në fushën e minierave 34 subjekte. Nga auditimi i dosjeve dhe i regjistrave të bizneseve debitore që administrojnë DAPPLL, 19 nga 34 subjekte rezultojnë debitorë për pagesën e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Kukës, në vlerën **48,779,162** lekë (vlerë e përfshirë të debitorët progresiv), sikurse janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela nr. 19: Subjektet që ushtrojnë aktivitetet në fushën e minierave

Nr.	Emri subjektit	Adresa	Debitor 31.12.2020	Ngarkesa 2021	Kamata 2021	Pagesa 2021	Debitor 31.12.2021
1	G.	Kukës		294,060	1,056	289,910	5,206
2	G.	BICAJ		404,504		404,504	
3	N. Mine	Kukës	5,374,042.69	1,240,000	189,720		6,803,762.69
4	K.	Kukës	5,054,792.58	1,471,420	225,127		6,751,339.58
5	K. Ch. Minerals	Kolsh	1,252,224	1,400,000	214,200	1,252,224	1,614,200.00
6	B.-Xh.	Kukës					
7	H.	Kukës	282,897.50				282,897.50
8	E.	Kukës		341,249	52,211		393,460.00
9	A.-T.-2014	Kukës					
10	M.-Xh.-2014	Kukës	4,133,502.83	1,413,380	216,247		5,763,129.83
11	M.	Kukës					
12	B.	Kalimash		2,010,500	307,607		2,318,107.00
13	L.	Surroj		238,390	36,474		274,864.00
14	A.D.& N.A. Sh.P.K	Surroj	1,040,453.26	300,150	45,923		1,386,526.26

¹²Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

15	K. K.	Kolesian		70,798	10,832		81,630.00
16	I.	Kolsh	628,930	185,000	28,305		842,235.00
17	N. B.	Surroj		893,000	10,720	903,720	
18	V. I.	Kolsh		728,934	38,019	766,953	
19	I. Indystri	Kalimash		4,974,043	438,648	5,412,691	
20	M. F.	Surroj		151,050		151,050	
21	K.- Th.	Kalimash		227,450		227,450	
22	K. M.	Shemri					
23	Albania N. C.	Surroj	4,590,580.75	2,162,500	330,863		7,083,943.75
24	M. F. Albania	Surroj	1,306,187.50				1,306,187.50
25	T. Alb C.	Kolsh	4,632,196.85	5,771,500	873,860		11,277,556.85
26	V. D.	Kukës		897,384	137,300	815,460	219,224.00
27	L.	Gjegjan		897,384	137,300	815,460	219,224.00
28	S.	Surroj	679,981.75	367,500	56,228		1,103,709.75
29	V. 2-M.	Kukës					
30	T. Minerals	Gjegjan		446,500		446,500	
31	A. F.	Kukës	640,558.37	356,808	54,592		1,051,958.37
32	L.	Surroj		627,000		627,000	
33	A. B.	Kolsh		375,250		375,250	
34	I.-07	Kolsh		201,500	24,563	226,063	
			29,616,348.09	28,447,254	3,429,795	12,714,235	48,779,162.08

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në prodhimin e energjisë (HEC-et)

Në Bashkinë Kukës ushtrojnë aktivitet 20 subjekte në fushën e prodhimit të energjisë. Nga shqyrtimi i dosjeve dhe i regjistrit të debitorëve që administron DAPPLL, 6 nga 20 subjekte janë debitorë për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **18,259,407**lekë (vlerë e përfshirë te debitorët progresiv).

Tabela nr. 20: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në prodhimin e energjisë (HEC-et)

Nr.	Emri subjektit	Adresa	Debitor 31.12.2020	Ngarkesa	Kamatëvonesa 2021	Pagesa 2021	Debitor 31.12.2021
1	E.E. Group	Kukës	-	6,452,956		6,452,956	
2	E. -Y Energy	Kukës	348,406				348,406
3	B. G. Energy	Zapod	179,745	1,041,293	159,318		1,380,356
4	Gj. Spa P.	Kukës	-	10,445,883	1,369,877		11,815,760
5	E. P.	Shtiçen	-	5,346,658	320,800	5,667,458	
6	H. Energji	Shishtavec	-	5,946,794		5,946,794	
7	E. E.	Shemri					
8	H. B.	Bushtricë					
9	L.& K. Energy	Bicaj					
10	L.- Sh.	Shemri					
11	L. Energy	Malzi		492,108		492,108	
12	A. Energy	Zapod		8,064,934		8,064,934	
13	E .	Orgjost		3,376,591		3,376,591	
14	H.V.1&2	Shemri					
15	E.Energy	Malzi		951,770	1,142	952,912	
16	H. T.	Bushtricë		334,168		334,168	
17	G.- E.	Kukës					
18	K. H.	Kalis	279,100	250,000			529,100
19	E.	Ujmisht	2,987,036	1,006,504	153,995		4,147,535
20	R.. E.	Tiranë	38,250	250,000		250,000	38,250
			3,832,537	43,959,659	2,005,132	31,537,921	18,259,407

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira

Titulli i gjetjes 11: Mbi të ardhurat nga asetet e dhëna me qira.

Situata: Bashkia Kukës në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi¹³ për administrimin e asetëve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 19 kontrata për dhënie me qira të asetëve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur në vijimësi bazuar në legjisllacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1 deri në 9 vjet. Kontratat janë lidhur me operatorët e telefonive celulare për instalim të kullës së antenave dhe aksesoret e tyre, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullësore për ndërtimin e HEC-ve, depozitim materialesh nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në nxjerrjen e mineraleve, etj.

Tabela nr. 21: Përmbledhje e pagesave për asetet e Bashkisë Kukës të dhëna me qira

Nr.	Subjekti	Kontrata (nr. datë)	Afati	Sip/ Ha	Vlera vjetore e kontratës	Debitor 31.12.2021
1	E.sh.p.k &E.-Grup sh.p.k	Nr.850 prot datë 07.02.2017 Amenduar me Nr. 3869 prot Datë 05.10.2018	5	0.467	411,598	1,234,794
2	E.-P.-sh.p.k	Nr. 20 Prot Datë 21.05.2018	3	0.53	254,040	0
3	E.-sh.p.k	Nr.32 Prot Datë 09.07.2019	3	0.3262	346,083	692,166
4	E.-sh.p.k	Nr.39 Prot Datë 08.08.2018	3	0.0751	11,911	23,822
5	Q. L.	Nr.67 Prot / 18.09.2017	8	1	101,000	0
6	O.	Nr.46 Prot 01.06.2016	9	0.015	82,500	0
7	Gj.	Nr.1 Prot 06.01.2020	1		834,464	0
8	N.-B.-shpk	Nr.1283/1 Prot 27.03.2017	8	1.085	108,500.00	0
9	V.I.- shpk	Nr. 41 Prot Dt. 31.07.2019	5	1.748	105,348.00	0
10	V. I.-shpk	Nr.42 Prot Dt. 31.07.2019	5	1.2	307,800.00	0
11	“A.-K.”shpk	Amendim Nr. 29/3 Datë 04.07.2018	3	2.0016	657,125.00	0
12	“V. Albania”sh.a	Nr.46 Prot Dt. 10.04.2017	5	0.006	51,000	0
13	“V. Albania”sh.a	Nr. 5336 Rep / Nr. 1926 Kol Dt. 01.05.2015	7	0.03	300,000	0
14	“V. Albania”sh.a	Nr. 1399 Rep dhe Nr. 198/1 Kol Dt: 17.04.2014 nr. 4951 Prot date: 03.11.2022	5	0.025	25,000	0
15	V. B. N.- sh.p.k	Nr.88 prot dt: 18.12.2020	5	0.9	652,239	0
16	G. D. -E sh.p.k	Nr. 87 prot dt 18.12.2020	5	2.1349	894,479	0
17	A.	Nr. 3063 Rep, nr. 1034 Kol datë 09.09.2009	9	0.04	300,000	993,333
18	Z. L.	Nr. 68 prot datë 31.10	9	0.01	575	0
19	L. & K. Energy "sh.p.k	Datë 19.12.2017	3		903,264	1,806,528
						4,750,643

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i kontratave të qirave dhe dokumentacionit lidhur me pagesat për të gjitha kontratat, rezulton se, jo të gjitha subjektet qiramarrëse kanë paguar rregullisht detyrimet që lindin nga kontratat. Nga 19 kontrata qiraje aktive kanë paguar detyrimet rregullisht vetëm 14 qiramarrës, ndërsa 5 qiramarrës (E.-SHPK&E.-GrupSHPK, E.-SHPK-2 kontrata, A.Sh.A, L. & K. Energy SHPK ") nuk i kanë paguar detyrimet referuar kushteve të kontratës që arrijnë në vlerën totale 4,750,643lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës më datë 31.12.2021.

Rezulton se, subjektet E.-Sh.p.k-2 kontrata dhe L.&K. Energy kanë paguar detyrimet gjatë vitit 2022 ndërsa subjekti A. Sh.A, ka lidhur marrëveshje për pagesë më këste ku ka paguar vlerën 600,000 lekë dhe i mbeten për të paguar edhe 393,333 lekë. **Si rezultat vlera e të ardhurave të**

¹³ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

munguara nga mos pagesa e detyrimit për kontratat e qirave aktualisht është 1,628,127 lekë(4,750,643 - 692,166 - 23,822 - 1,806,528 - 600,000 =1,628,127).

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave nuk disponon një regjistër të plotë dhe të përditësuar për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënie me qira të aseteve të bashkisë. Nuk janë të regjistruara saktë afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit. Për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për mos arkëtimin e detyrimeve që lindin nga kontratat e qirave janë z. S. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Kukës nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrin masa që qiramarrësit E.-SHPK&E.-Grup SHPK, dhe A. Sh.A të paguajnë detyrimet referuar kushteve të kontratës në vlerën totale **1,628,127 lekë** (E. në vlerën 1,234,794 lekë dhe A. Sh.A në vlerën 393,333 lekë). Gjithashtu, në vijimësi DAPK të ndjekë me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave.

DAPK të hartojë një regjistër të plotë dhe të saktë për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënie me qira të aseteve të bashkisë. Të përditësojë saktë të dhënat që lidhen me afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit.

Mbi realizimin e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Kukës

Titulli i gjetjes 12: Nivel i ulët i arkëtimit të gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Kukës.

Situata:

Organizimi dhe funksionimi i IMTV-së Kukës

Për vitin 2021, IMTV ka patur në strukturën e tij, 7 punonjës (6 inspektorë dhe 1 Kryeinspektor). Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Kukës është ngritur dhe funksionon në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4.

Mbi aktivitetin e IMTV-së për vitin 2021

Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Kukës u konstatua se **për vitin 2021** janë dhënë 73 masa “Dënim me gjobë”. **Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2021 është 26,150,000 lekë.** Janë paguar në mënyrë vullnetare vetëm **4 gjoba** me vlerë **250,000 lekë** dhe mbeten për tu paguar **59 gjoba** me vlerë totale **25,900,000 lekë.**

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat ligjore që janë marrë nga IMTV Kukës për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave rezultoi se, ka filluar procesi për të arkëtuar gjobat që nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore. Të gjithë kundërvajtësit janë njoftuar për detyrimin që kanë si rezultat i shkeljes që është konstatuar nga IMTV. Janë filluar procedurat për të dërguar në gjykatë të gjitha gjobat për të bërë të mundur nxjerrjen e titullit ekzekutiv si dhe disa gjoba janë dërguar në përmbarrim. Edhe pse nga ana e IMTV janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimin të gjobave, rezultoi se masat e marra kanë qenë të vonuara dhe ende nuk kanë dhënë rezultat e duhura, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9 “Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarrimor, sipas këtij ligji”, neni 22, pika 1, “Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarrimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji”, neni 3, pika 5 “Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë”.

Gjithashtu, rezultoi se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë¹⁴.

Përveç gjobave të vendosura në vitin 2021 IMTV është në proces të ndjekjes së procedurave të arkëtimin edhe për gjobat e tjera të vendosur më herët. Në tabelën në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur gjobat që janë në proces nga IMTV.

Tabela nr.22: Përmbledhëse e gjobave që janë në proces për t'u arkëtuar

Viti	Nr. gjobave	Vlera
2018	8	1,050,000
2019	17	3,810,000
2020	32	279,070,000
2021	59	25,900,000
Totali	116	309,830,000

Burimi: IMTV Kukës, përpunoi grupi i auditimit

IMTV ka dërguar periodikisht informacion në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit lidhur me gjobat e vendosura, nga ana e kësaj të fundit rezultoi se është bërë kontabilizimi i gjobave.

Për sa më sipër rezultoi se, **në fund të vitit 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 309,830,000 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z.E.D. me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së për vitin 2021.

¹⁴ Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve pika 1, “Gjoha dhe shumata, që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur.....pika 3 “Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 për qind në muaj të masës së gjobës, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatëvonesat”.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5.

Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës nga mos arkëtim i gjobave të vendosura nga IMTV.

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit nga IMTV për ndjekjen e hapave ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale **309,830,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021

Mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit” dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjsteve që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njëjsteve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj “dhe dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjsteve të Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar më datën 26.02.2022 në Degën e Thesarit Kukës, brenda afatit ligjor.

Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetëror do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Objektivat e auditimit: Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.
- Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.
- Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si: transaksionet, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar: Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Kukës, është realizuar në mbështetje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, dhe ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Pasqyrat financiare janë plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe formatet e miratuara nga Ministria e Financave.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare

Në fund të periudhës ushtrimore 2021 janë plotësuar 7 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr.08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022.

Formati 1 – Pasqyra e Pozicionit Financiar

Formati 2 – Pasqyra e Performancës Financiare

Formati 3 – Pasqyra e Flukseve Monetare (*Cash Flow*)

Formati 4 – Pasqyra e ndryshimeve në Aktivitet Neto/ Fondet Neto

Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese

Formati 6 – Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit

Formati 7/a – Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike

Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto

Formati 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.

Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme.

b. Kontrollat të llogarive dhe dokumenteve

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivitet neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivitet = **3,202,277,405** lekë.

	Viti 2021
AKTIVET	4,863,739,646
PASIVET(DETYRIMET)	1,661,462,241
AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,202,277,405

Burimi: Bashkia Kukës

1.1 Aktivitet afatshkurtra

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **1,124,735,135** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 280,267,814 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 86,174,238 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 650,248,173 lekë dhe “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 108,044,910 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti i 2020	Diferenca 2021-2020
531	Mjete monetare ne arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	19,001,586	-	19,001,586
520	Disponibilitete në thesar	261,266,228	193,773,136	67,493,092
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provizjone zhvlerësimi	-	-	-
	TOTALI	280,267,814	193,773,136	86,494,678

Burimi: Bashkia Kukës

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën **261,266,228**lekë, përbëhet nga:

- Llog 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën 15,423,224 lekë; dhe
- Llog 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” që ndërkohë është në shumën 142,935,930 lekë.

Titulli i gjetjes 13: Mos raportim i saktë në bilanc i llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar”.

Situata: Llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” nuk paraqet gjendjen e saktë në bilanc. Kjo llogari duhet të sistemohet për diferencën 102,907,074 lekë, ku nga 280,267,814 duhet të jetë 158,359,154 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP” pika 46/a , 49, 50.

Kriteri: UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36. Ligji nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin” neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103

Ndikimi: Paraqitja jo e saktë në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse të disponibilitetit në thesar, keq informon subjektin mbi gjendjen reali si dhe përdoruesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kukës.

Shkaku: Mosnjohje e legjislacionit të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marri masa për sistemimin e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” në vlerën **158,359,154 lekë**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M. I.

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2020-2021
31	Materiale	6,665,991	4,307,698	(2,358,293)
32	Objekte inventari Inventar i imët	79,508,247	77,526,928	(1,981,319)
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizione për zhvlerësim te inventarit(-)			
	TOTALI	86,174,238	81,834,626	(4,339,612)

Burimi: Bashkia Kukës

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kukës në 31.12.2021 paraqitet në vlerën **86,174,238 lekë** dhe përbëhet nga:

- Llogaria kontabël 31 “Materiale” për shumën 6,665,991 lekë;

- Llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” për shumën 79,508,247 lekë;

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit dhe materialeve, e cila kuadron me llogarinë 63 ”Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit” në shumën (4,339,612) lekë.

- **Llogaria 312 “Materiale”** ka vlerën 6,665,991 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2021	4,307,698
Hyrjet në magazinë gjatë vitit 2021	65,596,910
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	63,238,617
Gjendja në 31.12.2021	6,665,991

Burimi: Bashkia Kukës

- **Llogaria 327 “Objekte inventari”** ka vlerën 79,508,247 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	77,526,928
Hyrje gjatë vitit 2021	5,575,579
Dalje gjatë vitit 2021	3,594,260
Gjendja në 31.12.2021	79,508,247

Burimi: Bashkia Kukës

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Kukës ka nxjerrë Urdhër nr.620 date 03.11.2021 "Për fillimin e procedurës se inventarizimit te vlerave materiale (aktiveve) pajisjeve/mjeteve ne inventar të Bashkisë Kukës". Me këtë urdhër janë ngritur 9 Komisione me nga 3 anëtarë secili. Urdhër nr.620/1 date 03.11.2021 "Për fillimin e procedurës se inventarizimit të vlerave materiale (aktiveve) pajisjeve/mjeteve në inventar të Njësi Administrative të Bashkisë Kukës". Me këtë urdhër janë ngritur 14 Komisione (një për çdo njësi) me nga 3 anëtare secili, për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve, shoqëruar me Programin e punës për secilën njësi shpenzuese.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

- Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2020-2021
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	106,992	106,992	0
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione të tjera publike	-	-	-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-	-
468	Debitorë te ndryshëm	507,510,537	53,079,770	(454,430,767)
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	142,630,644	99,606,460	(43,024,184)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	-
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	-	-	-
	TOTALI	650,248,173	152,793,222	(497,454,951)
	Të tjera aktive afatshkurtra	-	-	-
409	Furnitorë(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	108,044,910	72,622,344	(35,422,566)
	TOTALI	108,044,910	72,622,344	(35,422,566)

Burimi: Bashkia Kukës

- **Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"** në fund të vitit 2021 është në vlerën 507,510,537 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepricën e vitit 2020 dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite në shumën 53,079,770 lekë me 454,430,767 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	53,079,770
Shtesa gjatë vitit 2021 debitorët e taksave (D)	454,430,767
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	-
Gjendja në 31.12.2021	507,510,537

Burimi: Bashkia Kukës

Gjatë shqyrtimit të llogarive analitike për vitin 2021 janë evidentuar debitorët për taksat dhe tarifave vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Kukës, janë evidentuar detyrimet për vitin 2021, detyrime të cilat paraqitet si më poshtë vijon:

Debitorë Bashkia Kukës dhe NJA	Gjendja 31.12.2021
Debitorë për tatimet dhe taksat vendore	135,697,321
Debitorë për kontratat e dhënies me qera	2,303,446
Debitorë gjoba e IMTV	316,430,000
TOTALI	454,430,767

Burimi: Bashkia Kukës

Llogaria analitike nuk reflekton të ketë diferencë midis llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” të njohur në bilanc. Në bilanc nuk janë futur detyrimet e nxjerra nga auditimi i mëparshëm i KLSH mbi individët dhe furnitorët debitor nga mos arkëtimi i dëmeve ekonomike, sepse janë shlyer në vitin ushtrimor 2022, për llogari të vitit 2021.

Ky veprim është kryer në përputhje me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, ku citohet:

“Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga:

- Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm.
- Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm.

Të drejtat. Funkzionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitoheh (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116).

Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve).

Funksionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë:

a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat:

- Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit);
- Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve direkte);
- Kreditohet klasa 7 me analiza;
- Kreditohet 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje).

b) Arkëtohen të drejta të konstatuara:

- Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza;
- Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza.

c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:

- Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);
- Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;
- Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)”

Pra për periudhën ushtrimore 2021 është paraqitur saktë Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke mos krijuar mbi apo nën vlerësime llogarie.

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 142,630,644 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 142,630,644 lekë. Vlera prej

142,630,644 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	99,606,460
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	142,630,644
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	99,606,460
Gjendja në 31.12.2021	142,630,644

Burimi: Bashkia Kukës

Në mënyrë analitike paraqitet:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	79,959,784
42	Detyrime ndaj personelit	25,130,216
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	9,378,478
435	Sigurime Shoqërore	25,808,358
436	Sigurime Shëndetësore	2,130,722.00
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	223,086
TOTALI		142,630,644

Burimi: Bashkia Kukës

- **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 108,044,910 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	72,622,344
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	75,994,035
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	40,571,469
Gjendja në 31.12.2021	108,044,910

Burimi: Bashkia Kukës

Llogaria	Tipologjia e detyrimeve financiare	Vlera në lekë
4864100	Detyrime te prapambetura per vendime gjyqesore	1,063,545
4864200	Detyrime te prapambetura per sherbime	19,147,755
4864400	Detyrime te prapambetura per investime	45,071,088
4864600	Detyrime te prapambetura per mallra	11,020,394
4864601	Detyrime te prapambetura per sigurime shoqerore	15,801,265
4864602	Detyrime te prapambetura per sigurime shendetesore	1,274,221
4864603	Detyrime te prapambetura per tatimet mbi te ardhurat personale	8,050,251
4864900	Detyrime te prapambetura per tatime te tjera	6,616,391
	Detyrime të prapambetura total	108,044,910

Burimi: Bashkia Kukës

Vlera e kësaj llogarie në shumën **108,044,910 lekë**, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2021 ka patur shtim (në vlerë absolute) të kësaj llogarie për 35,422,566 lekë dhe janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve si më poshtë:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Detyrime te prapambetura per vendimet gjyqesore	2,000,000
Detyrime te prapambetura per sherbime	3,000,000
Detyrime te prapambetura per Investime	22,675,776
Detyrime te prapambetura per tatimet mbi te ardhurat personale	5,187,933

Detyrime te prapambetura per tatime te tjera	2,970,468
Detyrime te prapambetura per sigurime shoqerore	4,611,850
Detyrime te prapambetura per sigurime shendetesore	125,442
Totali	40,571,469

Burimi: Bashkia Kukës

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pa financuara".

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t'u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

1.1 Aktivet afatgjata

Mbi Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale" në vlerën prej **13,032,892 lekë** përbëhen nga:

- **Llog.202 "Studime dhe kërkime"**, në vlerën 13,032,892 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	11,077,958
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	1,954,934
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	13,032,892

Burimi: Bashkia Kukës

Diferenca në rritje e llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" përfaqëson sistemimin e vitit 2021 për amortizimin e mbartur në llogarinë 202 "Studime dhe kërkime".

Testi substancial

Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën neto 13,032,892 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 "Studime e kërkime" e cila është dhënë në mënyrë analitike si mëposhtë:

Nr.	EMERTIMI	Viti i Ndërtimit	Vlera fillestare	Vite në Përdorim	Amortizimi	Vlera Mbetur
1	Studime e Kërkime	2013	166,911	9	0	166,911
2	Projekte	2005	1,345,000	17	0	1,345,000
3	Projekte	2012	300,000	10	0	300,000
4	Projekt Rikonstruksion i shkollës Bardhoc	2011	471,573	11	0	471,573
5	Projekte të ndryshme	2012	190,800	10	0	190,800
6	Projekte të ndryshme	2011	186,000	11	0	186,000
7	Projekte	2012	500,000	10	0	500,000
8	Studime projektive	2011	280,000	11	0	280,000
9	Projekte	2012	1,114,541	10	0	1,114,541
10	Studime e Kërkime	2012	1,056,953	10	0	1,056,953

SHUMA	5,611,778		5,611,778
--------------	------------------	--	------------------

Burimi: Bashkia Kukës

Titulli i gjetjes 14: *Pasaktësi në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.*

Situata: Nga verifikimi i analitikëvetë llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të përkasin edhe objekteve të përfunduara, duke siguruar vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 5,611,778 lekë.

Kriteri: Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ neni 6,9 dhe 10; UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

Ndikimi: Ky konstatim jep një paraqitje jo reale të vlerës financiare të pasqyruar në bilanc duke deformuar informacionin dhe gjendjen financiare të raportuar.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të kryej veprimet e sistemimit për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M. I.

Mbi Aktive afatgjata financiare

Testet substancialë

Aktive Afatgjata Financiarerezultojnë në fund të viti 2021 me vlerën 887,353,000 lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 0 lekë, siç shihet edhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	887,353,000	0
60	25	Huadhënie e Nënhuadhënie	0	0
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet	887,353,000	0

Burimi: Bashkia Kukës

Bashkia Kukës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 12,5% të aksioneve të Klubit të Futbollit Kukës si dhe 100% të Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh.A me NUIS përkatëse L18308201F dhe J67902228S.

Vlera aksionare që Bashkia Kukës zotëron në FK Kukësi është 15,000,000 (12,5% e kapitalit total 120,000,000) si dhe 872,353,000 lekë (vlera e kapitalit) në Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh.A e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit/eve të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre”. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kukës në “Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh.A “ si dhe vlera e kapitalit 12,5% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kukës në FK Kukësi është paraqitur në

aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë **26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”** për vlerën 887,353,000 lekë, në zbatim me urdhrin e ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet “Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 të SNK 27 e cila thotë:

Kur përgatiten pasqyra financiare individuale, investimet në filiale, në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe në sipërmarrjet që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në grupin e nxjerrjes jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 do të llogariten ose:

(a) me kosto, ose

(b) në përputhje me SNK 39.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **887,353,000** lekë dhe investitori është Bashkia Kukës

Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 3,649,573,288 lekë me kosto historike. Në vitin paraardhës 2020, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 3,646,200,397 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 17,590,639 lekë, si dhe të pakësimeve të AAM-ve për 14,217,748 lekë që kanë ardhur kryesisht si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT në Bashkinë Kukës.

Duke analizuar veprimet e shtesave dhe pakësimeve të AAM-ve, sipas të dhënave të siguruara nga Drejtoria e Finances dhe Buxhetit, gjendja në fund të vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2020	SHTESA	PAKSIME	Gjendja me 31.12.2021
1	210	Toka,troje,Terrene	70,974,458	0	0	70,974,458
2	211	Pyje,Kullota Plantacione	113,372,265	0	0	113,372,265
3	212	Ndërtime e Konstruksione	1,531,017,817	0	0	1,531,017,817
4	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,649,866,477	0	0	1,649,866,477
5	214	Instalime teknike, makineri,pajisje,vegla pune	49,034,034	6,973,360	5,346,000	50,661,394
6	215	Mjete transporti	166,733,331	0	0	166,733,331
7	218	Inventar ekonomik	59,789,524	7,573,692	5,828,161	61,535,055
8	24	Aktive afatgjata të dëmtuara	5,412,491	3,043,587	3,043,587	5,412,491
		TOTALI	3,646,200,397	17,590,639	14,217,748	3,649,573,288

Burimi: Bashkia Kukës

- **Llogaria. 210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 70,974,458 lekë, për të cilën ka inventar kontabël dhe inventar fizik.

Përshkrimi i aktivitetit	Cope	Dt e hyrjes, viti	Vlera e shpenz. Kapital e	Vlera e blerjes	Vendndodhja	Personi përgjegjës	Vlera e ak.e amortizimit
--------------------------	------	-------------------	---------------------------	-----------------	-------------	--------------------	--------------------------

Terrene sportive	1	2008		259,848	Shk.Bardhoc	Bilbil Shahu	0
Trull për ambulanca	1	2012		400,000	Nj.Ad.Shtiçen	Ilir Mucmata	0
Terren sportiv shk"Riza Spahiu"	1	2015		10,621,725	Lagje nr.6	Dr.Sherb.Pub	0
Terren sportiv shk"Bajram Curri"	1	2015		3,647,120	Lagje nr.1	Dr.Sherb.Pub	0
Këndi i lojrave me dore	1	2009		98,159,834	Lagje nr.2	Dr.Sherb.Pub	0
Fusha e stadiumit futbollit	1	2011		30,495,000	Lagje nr.2	Dr.Sherb.Pub	0
Stadiumi i qytetit "Zeqir Imeri"	1	2015		110,000,000	Lagje nr.2	Dr.Sherb.Pub	0
Terrene arsimore(oborre+ kënde lojrash etj)	1	2008		11,202,702	Shk. e Qytetit	Dr.Sherb.Pub	0
Terrene sportive në arsim 2007(undp bashki)	1	2007		1,544,262	Shk.A.Rustemi	Dr.Sherb.Pub	0
Terrene sportive në arsim 2007(undp bashki)	1	2007		1,160,671	Shk.R.Spahiu	Dr.Sherb.Pub	0
Terrene sportive në shkollat e Kukësit	1	2007		4,944,268	Shk. e Qytetit	Dr.Sherb.Pub	0
Terrene sportive në arsim 2007(undp bashki)	1	2007		1,139,673	Shk.B.Curri	Dr.Sherb.Pub	0

Burimi: Bashkia Kukës

Nga auditimi ka rezultuar se, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

- **Llogaria 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet e pandryshuar prej 0 lekë e pandryshuar dhe në 2021 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël, dhe as inventar fizik, por vetëm VKM nr.433, datë 8.6.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV.

Mungesa e inventarizimit dhe regjistrimit në ASHK të pasurive të njësisë vendore, si toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ka sjellë mos pasqyrimin në pasqyrat financiare të njësisë vendore për vitin 2021, duke bërë që këto pasqyra të mos paraqesin vlerën e saktë të këtyre asetëve të njësisë vendore.

Titulli i gjetjes 15: *Mangësi në regjistrin kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.*

Situata: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të regjistrimit dhe pajisjes me titull pronësie të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të paraqitur 0 lekë në bilanc, në kundërshtim me VKM nr.433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe

të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”.

Ndikimi/Efekti:Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë inventarizimin e përvitshëm të tyre, sjell mos pasqyrim të saktë të këtyre vlerave, si rrjedhojë e mungesës së informacionit në mënyrë analitike, për secilin aset si pasojë e mungesës së një regjistri kontabël.

Shkaku:Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Kukës dheNëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M. I.

Llogaria e aktivitetit 212 “ Ndërtesa dhe konstruksione”e cila pasqyron gjendjen e aseteve për llogari të Bashkisë Kukës, në fund të vitit 2020 rezulton me një kosto historike **1,531,017,817 lekë** dhe në fund të vitit 2021 rezulton me një kosto historike **1,531,017,817 lekë**. Lista me kosto historike e ndërtesave dhe konstruksioneve së bashku me përlogaritjen e amortizimit total dhe vjetor për vitin 2021 paraqitet në aneks 2.3.1;

Titulli i gjetjes 16:*Mangësi në regjistrin kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale.*

Situata: Aktivet afatgjata materiale të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në vlerën 1,531,017,817 lekë janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Kukës nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre.

Kriteri:VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”

Ndikimi:Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë njohjen e pronës dhe statusin juridik të saj, lë hapësirë për interpretim jo të saktë të vlerës së pasqyruar në bilanc.

Shkaku:Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Kukës dheNëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Kukës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M. I.

- Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Kukës më datë 31.12.2021 në shumën 22,708,181 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2020 në vlerën 22,708,181 lekë. Që do të thotë se gjatë vitit 2021 ka patur pakësim në Llogarinë 215 “Mjete transporti” për vlerën 5,677,045 lekë për amortizim.

Lista me kosto historike e ndërtesave dhe konstruksioneve së bashku me përlllogaritjen e amortizimit total dhe vjetor për vitin 2021 paraqitet në aneks 2.3.2;

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	22,708,181
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	5,677,045
Gjendja në 31.12.2021 (D)	22,708,181

Burimi: Bashkia Kukës

- Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik” përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kukës. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kukës gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën **61,535,055** lekë (kosto historike) dhe rezultati i së cilës paraqitet si në tabelën më poshtë:

Lëvizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2021, në lekë	
Çelje me 01.01.2021	59,789,524
Blerje me pagesë (D)	5,374,616
Shtesa pa pagesë donacione dhurata	2,199,076
Dalje (K)	5,828,161
Amortizimi i vitit i akumuluar 2021	52,952,509
Gjendja me 31.12.2021 (D) Teprica Neto	8,582,546

Burimi: Bashkia Kukës

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” amortizimin e akumuluar vjetor sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 52,952,509 lekë duke përdorur normë amortizimi 20%, në përputhje me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet “ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara”, ndryshuar me UMF nr.5, datë 21.02.2022. Lista me kosto historike e ndërtesave dhe konstruksioneve së bashku me përlllogaritjen e amortizimit total dhe vjetor per vitin 2021 paraqitet në aneks.

-Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” paraqet vlerën e aktiveve afatgjata të dëmtuara në pronësi të Bashkisë Kukësmë datë 31.12.2021 në shumën 5,412,491 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2020 në vlerën 5,412,491 lekë është e njëjtë. Që do të thotë se gjatë vitit 2021 nuk ka patur shtesa apo pakësime në Llogarinë 24 “aktive afatgjata të dëmtuara”, deri në ekzekutimin e daljeve fizikisht nga Inventari i Bashkisë Kukës.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	5,412,491

Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	5,412,491

Burimi: Bashkia Kukës

- **Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kukës në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 1,100,466,218 lekë, rezultati i së cilës ka ardhur i pasqyruar si në tabelën mëposhtë:

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Akivet afatgjata me vlerë neto”

Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/O MATERIALE	13,032,892	1,954,934	11,077,958	0	0	0	1,954,934	13,032,892	0	13,032,892
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0					0	0	0
202	Studime dhe kerkime	13,032,892	1,954,934	11,077,958				1,954,934	13,032,892	0	13,032,892
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	0	0	0					0	0	0
21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	3,646,200,397	974,044,299	2,672,156,098	17,590,639	132,394,507	14,217,748	5,983,593	3,649,573,288	1,100,455,213	2,549,118,075
210	Toka,troje, Terene	70,974,458	3,548,723	67,425,735				3,548,723	70,974,458	0	70,974,458
211	Pyje,Kullota Plantacione	113,372,265	0	113,372,265					113,372,265	0	113,372,265
212	Ndertime e Konstruksione	1,531,017,817	403,391,042	1,127,626,775		56,381,339			1,531,017,817	459,772,381	1,071,245,436
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,649,866,477	337,785,467	1,312,081,010		65,604,051			1,649,866,477	403,389,518	1,246,476,959
214	Instalime teknike,makineri,pajsije,vegla pune	49,034,034	37,729,220	11,304,814	6,973,360	2,586,435	5,346,000		50,661,394	40,315,655	10,345,739
215	Mjete transporti	166,733,331	138,348,105	28,385,226		5,677,045			166,733,331	144,025,150	22,708,181
216	Rezerva shtetore	0	0	0		0			0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0		0			0	0	0
218	Inventar ekonomik	59,789,524	53,241,742	6,547,782	7,573,692	2,145,637	5,828,161	2,434,870	61,535,055	52,952,509	8,582,546
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	5,412,491	0	5,412,491	3,043,587		3,043,587		5,412,491	0	5,412,491
28	Caktime	0	0	0					0	0	0
	TOTALI (I + II)	3,659,233,289	975,999,233	2,683,234,056	17,590,639	132,394,507	14,217,748	7,938,527	3,662,606,180	1,100,455,213	2,562,150,967

Burimi: Bashkia Kukës

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë jo në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, ndryshuar me UMFE nr.05, datë 21.02.2022.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Kukës, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25 %
- për mjetet e transportit 13.8 %
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Për llogaritë e mësipërme rezultojnë se është aplikuar norma e amortizimit 20 % dhe jo 13.8% për llogarinë 215”Mjete Transporti”, rezultati i së cilës duhet të jetë 142,265,266 dhe teprica neto 24,468,065 lekë. Kjo ka sjellë që llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM” të mbivlerësohet me 1,759,884 lekë, vlera e së cilës duhet të jetë 1,098,695,329 lekë nga 1,100,466,218 lekë.

Titulli i gjetjes 17:*Mbi sistemimin e normave të amortizimit të llogarisë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”.*

Situata:Për llogarinë 215 “Mjete transporti” rezultojnë se është aplikuar norma e amortizimit 20 % dhe jo 13.8%, rezultati i së cilës duhet të jetë 142,265,266 dhe teprica neto 24,468,065 lekë. Kjo ka sjellë që llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM” të mbivlerësohet me 1,759,884 lekë, vlera e së cilës duhet të jetë 1,098,695,329 lekë nga 1,100,466,218 lekë.

Kriteri: Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, ndryshuar me UMFE nr.05, datë 21.02.2022.

Ndikimi: Mbivlerësim i llogarisë të amortizimit dhe nënvlerësim i llog. 219

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryej sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 219 Amortizimi i AAGJM & AAJM, respektivisht në vlerën 1,098,695,329 lekë për vitin 2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M. I.

Mbi Investimet

- **Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në vlerën 289,500,544 lekë. Ky vlerësim financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jomateriale sipas tabelës mëposhtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 289,500,544 lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	21,099,686
2	Aktive Afatgjata materiale	268,400,858
3	Totali	289,500,544

Burimi: Bashkia Kukës

Për investimet e kryera gjatë vitit 2021, është debituar saktë llogarinë 231 dhe kredituar llogaritë e klasës 4. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata".

1.1 PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

- **Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kukës më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë	PERSHKRIMI	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	79,959,784	27,340,054	52,619,730
42	Detyrime ndaj personelit	25,130,216	24,746,504	383,712
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	9,378,478	14,509,128	-5,130,650
435	Sigurime Shoqërore	25,808,358	30,213,472	-4,405,114
436	Sigurime Shëndetësore	2,130,722.00	2,195,408	-64,686
437,438,	Organizma tjetërështetërore	223,086	208,960	14,126
464	Det.për tu paguar për bl.letrave me vlere	887,353,000		887,353,000
466	Kreditorë për mjete ne ruajtje	15,423,224	10,607,978	4,815,246
467	Kreditorë tëndryshëm	108,437,844	73,015,278	35,422,566

4341	Operacione me shtetin (detyrime)	53,186,762	53,186,762	0
Shuma - Llogari të Pagueshme		1,207,031,474	236,023,544	971,007,930
470	Llogari ne pritje - Te ardhurapër tu marrë	454,430,767		454,430,767
Shuma - Te tjera pasive afatshkurtra		454,430,767	0	454,430,767
Gjendja më fund të periudhës		1,661,462,241	236,023,544	1,425,438,697

Burimi: Bashkia Kukës

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në fund të vitit 2021 është në vlerën 79,959,784 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Kukës më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Lëvizja e Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Celje e vitit 2021	27,340,054
Shtesa (K)	113,812,539
Pakësime (D)	61,192,809
Gjendja në 31.12.2021 (K)	79,959,784

Burimi: Bashkia Kukës

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 79,959,784 lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në vitin pasardhës.

- **Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Kukës, paraqitet në vlerën 25,130,216 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për t’u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.

- **Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 9,378,478 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për periudhat e kaluara si dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2021 të cilat do të paguhen në periudhën pasardhëse.

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor 2021 si dhe detyrimet e viteve të kaluara përkatësisht në vlerat 25,808,358 lekë dhe 2,130,722 lekë.

-**Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kukës, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 15,423,224 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 15,423,224 lekë. Një kopje të raporteve të llogarisë 466 dhe nen llogarive përkatëse jepet në aneks 2.3.3

Lëvizja e Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2021	10,607,978
Shtesa	26,462,738
Pakësime	21,647,492
Gjendja në 31.12.2021	15,423,224

Burimi: Bashkia Kukës

Titulli i gjetjes 18: *Mbivlerësim i llogarisë 466 Kreditorë për mjete nën ruajtje.*

Situata: Vlera e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk është e njëjtë me terpicën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave

dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 10,607,978 lekë pjesa tjetër prej 4,815,246 lekë është në afat.

Kriteri: ligjin nr. 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10” ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 “ Kreditorë për mjete në ruajtje”, ndryshuar me UMFE nr.5, datë 21.02.2022.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, gjendje kjo e mbi vlerësuar për 1,169,275 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale **10,607,978 lekë** dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M. I.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**, paraqiten faturat e palikuiduara, vendime gjyqësore (nëse ka), investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në shumën 108,437,844 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2021	73,015,278
Shtesa gjatë vitit 2021 (d)	75,994,035
Pakësime gjatë vitit 2021(k)	40,571,469
Gjendja në 31.12.2021	108,437,844

Burimi: Bashkia Kukës

Titulli i gjetjes 19:*Nënvlerësim i llogarisë 467 Kreditorë të ndryshëm.*

Situata: Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Kukës nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021, në shumën **14,758,973 lekë**.

Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021 ka nënvlerësuar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me **14,758,973 lekë** për vitin 2021.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022, por me kompetencë vitin 2021, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me **14,758,973 lekë**.

Kriteri: ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave

financiare” ku përcaktohet qartë së detyrimet njihen në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 467 “Kreditore të ndryshëm”, gjendje kjo e nën vlerësuar për 3,173,309 lekë

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara **14,758,973 lekë** për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M. I.

- **Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”**, paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën 142,935,930 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Kukës trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordinin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

1. **Pasqyra e Performancës financiare (F2)**

-**Të ardhurat dhe shpenzimet**, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Kukësmë datë 31.12.2021 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Kukës, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Dif
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	149,755,685	Akt rakordimi me Degën e Thesarit	149,755,685	0
Granti nga buxheti	1,340,653,903	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	1,340,653,903	0
Financim i pritshëm nga buxheti	142,630,644	Sipas llogarisë 7206	142,630,644	0
Totali të ardhurave	1,633,040,232	Totali të ardhura	1,633,040,232	0

Burimi: Bashkia Kukës

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2020	Detyrime të vitit 2021	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	402,798,993	37,480,907	32,613,093	397,898,777
601	69,550,727	9,028,530	5,424,914	65,947,111
602	110,448,710	51,825,370	104,592,637	163,215,977
604	473,620	0	0	506,022
606	856,660,071			856,660,071

63	-4,339,612			-4,339,612
831	10,215,956			10,215,956
Totali	1,445,808,465	98,334,807	142,630,644	1,490,104,302

Burimi: Bashkia Kukës

Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 “shpenzimet” dhe klasës 7 “të ardhurat”, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	1,633,040,232	1,633,040,232	0
II	Shpenzime	1,490,104,302	1,490,104,302	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	142,935,930	142,935,930	0
IV	Rezultati i vitit ushtrimor	142,935,930	142,935,930	0

Burimi: Bashkia Kukës

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **142,935,930 lekë**, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

1. Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	177,632,879	31,680,528
II	Veprimtaritë e investimeve	-83,953,633	56,590,757
III	Transferta e të tjera	-7,184,568	-3,369,080
IV	Teperica në fillim të vitit ushtrimor	193,773,136	108,870,931
V	Teperica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor	280,267,814	193,773,136

Burimi: Bashkia Kukës

-Nga kontrollet e kryera rezultoi se teperica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2020, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën **280,267,814 lekë** dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën **280,267,814 lekë**.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare”, ndryshuar me UMFE nr.5, datë 21.02.2021.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Ref.	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Fonde te tjera te vetat	Rezultatet e Mbartura Tepriocje/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Tepriocje/Deficit	GJITHESEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	2,914,284,951				2,914,284,951
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	138,789,965	6,266,559	0	142,935,930	287,992,454

	1.NGA BURIME TE BRENDSHME	138,789,965	-13,468,076	0	142,935,930	268,257,819
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	104,841,076	76,105,224			180,946,300
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	6,221,832	153,430.00			6,375,262
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	92,407,182	-46,183,901	83,975,597		130,198,878
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	82,255,201		-83,975,597	142,935,930	141,215,534
115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	0	83,953,633			83,953,633
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	-139,811,294	-126,890,850			-266,702,144
1015	Nga nxjerrjet jashtëpërdorimit dhe dëmtimet(-)	-7,124,032	-605,612			-7,729,644
	2.NGA BURIME TE JASHTME	0	19,734,635	0	0	19,734,635
106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	0	19,734,635			19,734,635
1016, 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0				0
	TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	3,053,074,916	6,266,559	0	142,935,930	3,202,277,405

Burimi: Bashkia Kukës

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **3,202,277,405 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

-Vlera prej **542,689,607 lekë**, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

-Vlera prej **19,734,635 lekë**, përfaqëson shtesat ne fondet baze nga Grantet e jashtme Kapitale;

-Vlera prej **126,890,850 lekë**, përfaqëson amortizimin vjetor;

-Vlera prej **605,612 lekë**, përfaqëson nxjerrjet jashtë përdorimit;

-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën **3,202,277,405 lekë** kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

2.4 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

1. Auditimi i fundit në Bashkinë Kukës

Auditimi i fundit në Bashkinë Kukës është kryer në vitin 2021 për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2020, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 448/8 prot., datë 20.10.2021. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 27 masa organizative, pranuar nga subjekti;

- 5 masa për shpërbllim dëmi;

- 1 masë për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike;

- 1 rekomandim për masa disiplinore, ku vetë subjekti ka propozuar masa për 13 punonjës dhe realisht janë marrë vendime për 6 punonjës.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j “Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit”, Bashkia Kukëspër zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 448/8 prot., datë 20.10.2021, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 5205/1 Prot, datë 25.11.2021, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Bashkia Kukëska hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Rezulton se nga Bashkia Kukës nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH

Titulli i gjetjes 20: Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Situata: Sikurse është cituar më lart, Bashkia Kukëska hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH, me shkresën nr. 914 Prot., datë 25.11.2021 por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “*Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij*”.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Kukës të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Kukës me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Kukës

Titulli i gjetjes 21: Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit.

Situata:

Masa organizative:

1. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit”, grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi 2018-2020 testoi disa nga komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm, nga ku rezultoi:

- Bashkia Kukës ka funksionuar pa patur rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës e saj në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës.

-Nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës, konkretisht në fushat me risk siç janë prokurimet publike, zbatimi i buxhetit, mbledhja e taksave, etj.

-Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Kukës, nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

-Në vendimet e largimeve dhe emërimeve për 31 pozicioneve drejtuese sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.

-Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës.

- Në Bashkinë Kukës, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

-Nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Kukës nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut.

- Nuk është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut në nivel institucional sipas përcaktimit ligjor, edhe pse Drejtoria e Auditit të Brendshëm dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit ka regjistër risku vetëm për vitin 2020, si dhe nuk është emëruar personi për pozicionin Koordinatori i riskut.

-Për vitin 2018, për grupin e auditimit nuk është vendosur në dispozicion asnjë evidencë e cila provon ngritjen e grupit të GMS dhe caktimin e Koordinatorit të riskut me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Për vitin 2019 nuk është vendosur në dispozicion asnjë evidencë e cila provon caktimin e Koordinatorit të riskut me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Për vitin 2020 gjatë veprimtarisë së GMS, kjo strukturë nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, për arsye se nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet.

-Nuk janë përcaktuar rregulla me shkrim mbi veprimtaritë e kontrollit dhe ndarja e detyrave në mënyrë që:

a- të përcaktojnë ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave;

b-nuk është krijuar sistemimi i dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Kukës të merren masa për:

Hartimin e Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës e saj në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës;

Hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore;

Krijimin e procedurave për delegimin e detyrave;

Hartimin e gjurmëve standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës;

Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;

Vendosjen e një sistemi elektronik të mirëfilltë unik të mbajtjes së kontabilitetit;

Hartimin e mekanizmave të cilat t'i dedikohen ankesave për korrupsion;
Vendosjen e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT;
Ngritjen e komisionit nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që janë larguar nga detyra;
Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe Regjistrimit të Riskut në nivel institucional;
Të emëruar Koordinatorin e riskut;
Grupi i GSM të hartojë plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet.

Nga auditimi rezultoi se:

- Është hartuar rregullorja për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës. Rregullorja është miratuar me urdhrin nr. 328, datë 05.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë.
- Me Urdhrin nr.764 datë 10.12.2021, është bërë delegimi i disa kompetencave nga Kryetari i Bashkisë të Zv/ Kryetari, z. G. Gj. dhe Sekretari i Përgjithshëm, z. D. K.
- Me Urdhrin nr. 232, datë 06.09.2021 “Për një ndryshim në urdhrin për miratimin e gjurmës së auditit për “Administrimin e pjesëve të Këmbimit” dhe Urdhrin nr.230, datë 26.09.2019 “Për një ndryshim në urdhrin për miratimin e gjurmës së auditit për Administrimin e Karburantit”.
- Me Urdhrin nr. 503, datë 01.06.2022 është bërë ngritja e komisionit nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar nga detyra.
- Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është hartuar Regjistri i Riskut në nivel drejtorie për vitin 2021 dhe në nivel institucional për vitin 2022, ku është emëruar edhe Koordinatorin e Riskut me Vendim Nr. 11, datë 03.02.2021.

Statusi: Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kukës konstatohet se:

-Kodi i Etikës është hartuar nga Drejtoria e AB, por nuk është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kukës;

-Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, rezulton se:

a) Z. E. C., me arsim të lartë, profili drejtësi, është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.370/8, datë 01.03.2016, duke qenë i pa pajisur me certifikatën e audituesit;

b) Znj. M. V., me arsim të lartë, profili ekonomi agrare, është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 183, datë 13.09.2019, duke qenë e pa pajisur me certifikatën e audituesit.

-Mungon identifikimi i fushave me risk në sektorin IMTV, sektori i taksave dhe tarifave vendore, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me Ligji nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, nenin nr. 11, pika 2, shkronja “c” “ç”; MAB.

Manuali i auditimit të brendshëm” i miratuar me Urdhrin e MF me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e MAB në sektorin publik”. Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11

-Në programet dhe në procesin e auditimit të NJAB nuk rezulton ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, e cila sjellë shkallë të ulët të zbatimit të tyre nga subjektet e audituara. Ky rezultat shoqërohet në përmbledhjen ekzekutive të Raportit Vjetor të zbatimit të rekomandimeve të AB për vitin 2020, dërguar në MFE pranë NJQHAB me

shkresën nr. 1342, datë 08.04.2021, ku nga 106 rekomandime për vitin 2020, janë zbatuar 9 rekomandime, janë në proces 16 dhe janë të pazbatuara 81 rekomandime.

-Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi nuk i kanë zbatuar ato, nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën në vazhdim të organizohet dhe të funksionojë me punonjës të certifikuar, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Nga auditimi rezultoi se:

Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, gjatë vitit 2021, nuk ka funksionuar me specialistë të certifikuar si dhe aktualisht nuk funksionon sipas strukturës së miratuar përsa i takon Njesisë së Auditit të Brendshëm, pasi ka vetëm një përgjegjës dhe një specialist. Ka hartuar një program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna. Ka realizuar planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe ka kryer procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Statusi: Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018-2019-2020 nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës është punuar për të bërë saktësimin dhe evidentimin e kontratave dhe faturave të cilat nuk ishin pasqyruar më parë në tabelat e raportimeve të detyrimeve. Nga analizimi i të dhënave rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitet 2018-2019-2020 nuk përputhet me vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc, nuk përputhet me vlerën e detyrimeve sipas akt rakordimeve me thesarin si dhe nuk përputhet me vlerën në tabelat analitike që administron Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës sipas viteve përkatëse.

Vlera e detyrimeve të prapambetura për të cilat DFB disponon tabela analitike është shumë më e vogël se vlera e detyrimeve e raportuar në MFE apo vlera e paraqitur në bilancet përkatëse sipas viteve.

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës të ngrëjë një grup pune me qëllim analizimin, verifikimin, regjistrimin dhe përputhjen e vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura që ka Bashkia Kukës. Në përfundim të procesit të identifikimit dhe regjistrimit të saktë të detyrimeve, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të hartojë planin/grafikun e likuidimit të tyre në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi rezultoi se:

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është bërë verifikimi dhe regjistrimi i detyrimeve të prapambetura dhe në shkresën Nr.921 Prot., datë 23.02.2022 “ Dërgim i raportit të vetëvlerësimit për periudhën Janar – Dhjetor 2021” është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë edhe plani i shlyerjes për periudhën 2022 -2024.

Statusi:Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i radhës së likuidimit të vendimeve gjyqësore rezulton se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8. Vendime të regjistruara në vitin 2016 janë likuiduar në vitin 2020 (vendim nr. 312-247), vendime të regjistruara në vitin 2019 apo vitin 2020 janë likuiduar brenda vitit (vendim nr. 93, vendim nr. 583, vendim nr. 63). Nga auditimi i listave analitike mbi vendimet gjyqësore si dhe

vetë vendimet gjyqësore rezultojn se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit administrojnë vendime gjyqësore për ndërprerje të kontratës së punës të cilat nuk i ka të regjistruara dhe nuk i ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë përkatësisht, vendimi nr. 312(247), datë 04.05.2016 me vlerë 798,560 lekë, vendimi nr. 369, datë 29.05.2019, me vlerë 789,415 lekë, vendimi nr. 154, datë 13.06.2019, me vlerë 3,342,537 lekë dhe vendimi nr. 210, datë 01.10.2020 me vlerë 1,015,680 lekë. Në total vlera e vendimeve gjyqësore të pa regjistruara dhe të pa raportuara në MFE në përfundim të vitit 2020, e konstatuar nga grupi i auditimit, është 5,946,192 lekë. Nga auditimi i listave analitike dhe i vendimeve gjyqësore rezultojn se në raportimin e bërë në MFE janë raportuar si detyrime edhe tre vendime të cilat janë likuiduar në vitet 2019-2020 (vendim nr. 629, vendim nr. 597-131, vendim nr. 12-74).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj si dhe të hartojë grafikun e shlyerjes. Gjithashtu, të saktësojë vendimet gjyqësore që janë likuiduar dhe që vazhdojnë të raportohen si detyrime në Ministrinë e Financave, me qëllim identifikimin e vlerës reale të detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të pa likuiduara.

Nga auditimi rezultoi se:

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit janë evidentuar dhe regjistruar në vitin 2021 dhe 2022 të gjitha vendimet gjyqësore dhe detyrime të tjera të prapambetura. Vlera e detyrimeve të prapambetura e regjistruar në Degën e Thesarit është e njëjtë me vlerën e raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për periudhën Janar – Dhjetor 2021.

Statusi: Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës nuk merr informacion nga strukturat në varësi të bashkisë por edhe njësitë brenda Bashkisë lidhur me realizimin e procesit të planifikimit të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 1, datë 05.01.2018, VKB nr. 81, datë 04.01.2019 dhe VKB nr. 53, datë 24.12.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës. Në këto kushte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e kryen planifikimin e të ardhurave të veta kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave dhe tarifave që ka Bashkia Kukës, në ecurinë e realizimit të të ardhurave dy vitet paraardhëse. Nga analizimi i të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, parashikimi që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore bën bazuar në nivelet e realizimit nuk qëndron. Për shembull, në rastin e tarifës së “hapësirës publike” planifikimi për vitin 2018 është 525,300 lekë, ndërsa për vitet 2019-2020 është 541,059 lekë. Realizimi për vitin 2018 është 258%, për vitin 2019 – 233% dhe për vitin 2020-122% (tarifa është me tejkalim edhe pse është pjesë e masave lehtësuese që ka marrë Bashkia Kukës gjatë vitit 2020 në kohën e pandemisë Covid-19, nga 12 muaj subjektet kanë paguar për 7 muaj). Tarifa e pastrimit është po ashtu një shembull tjetër që mund të marrim për problemet në planifikimin e saj. Për këtë tarifë realizimi ka ardhur në rritje nga viti 2018-2019-2020 (135%-159%-176%), ndërsa planifikimi për këto tri vite është pothuajse i njëjtë (13,526,475 lekë).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Nga auditimi rezultoi se:

Për planifikimin e të ardhurave janë njoftuar me shkresë zyrtare të gjitha drejtoritë brenda Bashkisë Kukës për sjelljen e informacionit të duhur për planifikimin dhe bashkëpunimin për paketën fiskale dhe planifikimin e të ardhurave të veta ku është kryer dhe planifikimi i të ardhurave sipas zërave në vitin 2022. Planifikimi i të ardhurave është ndryshuar për vitin 2022 dhe është sistemuar për të gjithë zërat dhe identifikimi i nivelit të realizimit është i saktë.

Statusi: Zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2018 është realizuar në masën 1.2%, nga 525,300 lekë të planifikuara janë arkëtuar 6,505 lekë, për vitin 2019 është realizuar në masën 0.1% , nga 541,059 lekë të planifikuara janë arkëtuar 436 lekë, për vitin 2020 është realizuar në masën 16.3%, nga 541,059 lekë të planifikuara është arkëtuar vlera 87,961 lekë.

Për vitin 2020 sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, planifikimi i taksës së tokës është 541,059 lekë, ndërsa referuar përcaktimeve të VKB-së nr. 1, datë 05.01.2018, VKB-së nr. 81, datë 04.01.2019, VKB-së nr. 53, datë 24.12.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës si dhe të dhënave nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, prishmëria për taksën e tokës bujqësore është 2,370,800 lekë, diferenca në planifikim për vitin 2020 është **1,829,741 lekë** duke sjellë të ardhura të planifikuara më pak në buxhetin e bashkisë për vitin 2020 në vlerën **1,829,741 lekë**.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojë me Drejtorinë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës së tokës bujqësore si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën **1,829,741 lekë**.

Nga auditimi rezultoi se:

Taksa bujqësore është në proces të verifikimit në terren, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Njësitë Administrative, ku është nxjerrë lista me të gjitha sipërfaqet e tokave bujqësore. Aktualisht po punohet me saktësimin e të dhënave pasi ka disa lloje problematikash përse i përket tokës bujqësore, ku ndryshimet e pronarëve dhe një sipërfaqe e konsiderueshme e tokave bujqësore është në pronësi të shtetit, sepse njësia administrative Shtiqën, me sipërfaqe më të madhe të tokës bujqësore, nuk ka pranuar nxjerrjen e certifikatave bazuar në ligjin 7501 në kohën e ish Komunave dhe 90% e kësaj sipërfaqe është pa certifikatë pronësie. Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kukës është në proces për saktësimin e ndarjes së tokës bujqësore deri në përfundimin e përlogaritjes së taksës së tokës bujqësore.

Statusi: Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2018-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë **348 subjekte** të legalizuara me vlerë **13,194,899 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitore për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja që janë legalizuar për **348 subjekte** të legalizuara me vlerë **13,194,899 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kukës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nga auditimi rezultoi se:

Vlera totale e borxhit për Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë për numrin total të subjekteve debitoare, 348 subjekte, vazhdon të jetë 13,194,899 lekë. Për Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë janë njoftuar, bllokuar dhe sekuestruar të gjitha subjektet debitoare, nga pagesat për TNI është arkëtuar deri tani vlera prej 2,431,122 lekë.

Statusi: Në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Numri i familjeve debitorë në Bashkinë Kukës për vitin 2018 përbën 90.5% të familjeve, në vitin 2019- 91% dhe në vitin 2020-88.5%. Në fund të vitit 2020 vlera e detyrimit progresiv që rrjedh nga familjet debitorë është **6,546,829 lekë**.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Kukës të marrë të gjitha masat që të njoftojë familjet për detyrimet vendore që ato kanë ndaj bashkisë me qëllim arkëtimin e detyrimeve të kaluara në vlerën totale **6,546,829 lekë** si dhe të fillojë procedurat për të përfshirë agjentë tatimorë për vjeljen e taksave dhe tarifave familjare por jo vetëm.

Nga auditimi rezultoi se:

Për taksën familjare janë njoftuar subjektet debitoare dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore është në proces për vjeljen e detyrimeve. Ka filluar procedura për gjetjen e agjentëve tatimorë dhe aktualisht po punohet me Njësitë Administrative, për përpunimin e të dhënave për të gjitha familjet që përjashtohen nga taksat dhe tarifave familjare. Problematika kryesore është se ekziston një numër familjesh, që e kanë pasaportizimin në territorin e Bashkisë Kukës, por që nuk janë banues aty dhe po përpunohen të dhënat për familjet dhe pasuri të kategorive të ndryshme si vijon:

- Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- Banesat sociale në pronësi të Bashkive;
- Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë përdoren nga Bashkia si banesa sociale;
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet nga pensionistë të vetëm, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme.

Statusi: Në proces zbatimi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se numri i debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Kukës në fund të vitit 2020 është **104,101,257 lekë për 512 subjekte**.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Sektori për Menaxhimin e Borxhit të ndjekë zbatimin e urdhrave që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare, për sigurimin e detyrimit tatimor, për sekuestrimin e pasurisë apo kallëzimin penal me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej **104,101,257 lekësh** nga subjektet debitorë si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.

Nga auditimi rezultoi se:

Vlera totale e subjekteve debitoare është 104,101,257 lekë dhe numri total i subjekteve debitoare është 512 subjekte. Realizimi në total i mbledhjes së detyrimeve të prapambetura është në vlerën 8,804,874 lekë, që do të thotë se numri total i subjekteve që kanë paguar është 137 subjekte. Nga DTTV janë njoftuar dhe bllokuar 512 subjekte debitoare, ndërsa 13 subjekte me vlerën e detyrimit 5,964,062 lekë janë sekuestruar.

Statusi: Në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018-2020 Bashkia Kukës ka lidhur 19 akt marrëveshje me subjektet debitorë për të bërë të mundur likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifata vendore me këste. Nga këto rezultojnë se 17 subjekte i kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë ndërsa 2 subjekte (E.-B. dhe A.C.) nuk kanë respektuar kushtet e marrëveshjes. Gjithashtu, konstatohen mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht:

Për 11 nga 12 akt marrëveshjet e vitit 2019 nuk ka kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2.

Në asnjë rast nuk rezultojnë që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 5.

Dy nga akt marrëveshjet janë nënshkruar për detyrimet e periudhës (akt marrëveshja nr. 3150 Prot, 19.06.2020 dhe nr. 3036 Prot, 15.06.2020).

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste, si dhe të monitorojë zbatimin e kushteve të akt marrëveshjeve.

Nga auditimi rezultoi se:

Për sa i përket dy subjekteve të lëna nga ana e KLSH për akt marrëveshjet, janë ndjekur procedurat e vjeljes së detyrimeve dhe nga subjektet janë bërë pagesat përkatëse.

Statusi: Zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kukës janë 11 subjekte që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve për të cilat Bashkia Kukës nuk ka informacion nëse janë të pajisura me autorizim, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar neni 4, neni 20, pika 2, dhe nëse ky autorizim ka përfunduar apo kur përfundon.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që të identifikojë të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës si dhe të bëjë të mundur pajisjen e menjëhershme të tyre me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë.

Nga auditimi rezultoi se:

Të gjitha subjektet e tregtimit të hidrokarbureve (karburante) janë verifikuar në terren, ku janë mbajtur akt konstatime ku i kërkohet të paguajnë detyrimet vendore dhe pajisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse. Të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve janë pajisur me autorizimin për tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse, por janë ende 4 karburante me status aktiv në QKB që nuk janë pajisur me autorizim.

Statusi: Në proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës ka lidhur në total 17 kontrata për dhënien me qira të aseteve të bashkisë. Nga auditimi i tyre, për vitet 2018-2020 rezultojnë debitorë ndaj bashkisë 7 subjekte qiramarrëse në kundërshtim me kushtet e kontratës së qirasë në shumën totale të qirave **3,770,890 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës. Subjekti “A. Albania” ka pothuajse 3 vite që nuk ka kontratë të lidhur me Bashkinë Kukës për sipërfaqen që përdor për vendosjen e antenave.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të angazhohen që subjektet qiramarrëse të zbatojnë me përpikmëri kushtet e kontratave të qirasë me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën **3,770,890 lekë**. Gjithashtu, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin hapat e duhur ligjor ndaj subjektit “A. Albania” të cilit i ka përfunduar kontrata e qirasë më datë 08.09.2018 dhe ende nuk është bërë e mundur lidhja e një kontrate të re.

Nga auditimi rezultoi se:

Nga bashkëpunimi mes Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve janë njoftuar, bllokuar dhe vjelur detyrimet për kontratat në vlerën 2,947,694 lekë, duke përjashtuar subjektin E, që është akoma debitor për vlerën 823,196 lekë dhe për të cilin janë kryer të gjitha procedurat për vjeljen e detyrimit.

Statusi: Në proces zbatimi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiarerezulton se është nënvlerësuar llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogaria e 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatime”, duke mos e njohur të ardhurën për vitin 2018, në vlerën 99,178,561.1 lekë, për vitin 2019 në vlerën 88,294,922.7 lekë dhe për vitin 2020 në vlerën 110,185,946.3 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, 10,11, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin i MF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe buxhetit të kryejë veprimet sistemuese për gjendjen e llogarive 468 dhe 70 në fund të vitit ushtrimor 2020.

Nga auditimi rezultoi se:

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit ka bërë sistemimet në pasqyrat financiare sipas rekomandimeve të KLSH-së.

Statusi: Zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive analitike, rezultojnë se disa studime e projekte në vlerën 5,611,778 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga ish komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Kukës. Vlera e këtyre objekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit dhe përkatësisht sipas listës së paraqitur nga bashkia që para 2015 dhe kjo ka bënë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202” Studime e kërkime” si dhe nënvlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale me 5,611,778 lekë për 2019 dhe për 2020.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të sistemojë në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar, vlerën e këtyre objekteve si pjesë e kostos totale të objektit dhe përkatësisht sipas listës së paraqitur nga Bashkia që para vitit 2015 me shumën 5,611,778 lekë për vitet 2019 dhe 2020.

Nga auditimi rezultoi se:

Shuma e llogarisë “Studime dhe kërkime” e mbartur nga vitet e kaluara për shumën 5,611,778 lekë i përket viteve 2011-2013. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka mundur të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për të bërë sistemimin e rekomanduar meqenëse janë mbartje nga ish Komunat Surroj, Zpod, Malsi, Tërthore, Arren, Kolsh Bushtricë dhe Bicaj. Procesi po vazhdohet të ndiqet dhe sapo të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm do kryhen sistemimet sipas rekomandimeve.

Statusi: Në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2018,2019,2020 rezulton se nuk është kontabilizuar llogaria 26 “Pjesëmarrje me kapitalin e vetë” me vlerën e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kukës në “Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh.A”si dhe vlera e kapitalit 12,5% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kukës në Futboll Klub Kukësi në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të bilancit kontabël 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”. Në këtë rast investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 887,353,000 lekë dhe investitori është Bashkia Kukës. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 887,353,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar dhe është në kundërshtim me UM nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35.

15.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të FK Kukësi me vlerë kontabël 887,353,000 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Nga auditimi rezultoi se:

Nga Bashkia Kukës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues është kryer sistemimi dhe regjistrimi në kontabilitet për pjesëmarrjen në kapitalin aksionar të Klubi Futbollit Kukësi dhe Ndërmarrja e Ujësjetllësit Kukës.

Statusi: Zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2018,2019 dhe 2020 rezultoi se llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 67,425,735 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën ka inventar kontabël, por jo inventar fizik. Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet e pandryshuar prej 113,372,265 lekë dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme. Ky fenomen ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

16.1 Rekomandimi: Titullari Bashkia Kukës në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimin të Aseteve të marr masa për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në Grupin e Menaxhimit Strategjik, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat “Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione”. Ndërtesa dhe konstruksione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Kukës më 31.12.2020.

Nga auditimi rezultoi se:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës po kryen pagesat për llogari të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit për regjistrimin e pronave, deri në momentin që ato do regjistrohen në pasqyrat e pozicionit financiar.

Statusi: Në proces zbatimi

17. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kukës, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 10,607,978 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 10,607,978 lekë. Kjo shumë është e njëjtë me tepricën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520. Në fillim të vitit 2019 zyra e financës së Bashkisë Kukës për arsye të ndryshimeve dhe lënies së detyrave nga drejtuesit e mëparshëm, nuk ka patur asnjë informacion për detajimet e kësaj llogarie. Për këtë shkak janë gjurmuar veprimet dhe janë arritur të nxirren veprimet e kryera në sistemin e thesarit deri me 1 Janar 2010. Teprica e mbetur e pa detajuar (për shkak të mungesës së të dhënave për veprimet e kryera para datës 01/01/2010) është 9,295,828 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të Bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466, në kundërshtim me Ligjin nr. 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10” ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

17.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën 10,607,978 lekë Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Nga auditimi rezultoi se:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka bërë sistemimet në pasqyrat financiare sipas rekomandimeve të KLSH-së.

Statusi: Zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore dhe investime dhe shërbime, të cilat nuk bëhen hyrje të cilat për vitin 2020 janë në shumën 73,015,278 lekë. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Kukës nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2020, por të pa regjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019. Mos paraqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2019, ka nënvlerësuar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 10,504,919 lekë. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2020 por me kompetencë vitin 2019, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 10,504,919 lekë në kundërshtim me Ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Urdhër nr. 64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”.

18.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të pasqyrojnë në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara në 2020 por me kompetencë vitin 2019, për vlerën 10,504,919 lekë. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Nga auditimi rezultoi se:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka bërë sistemimet në pasqyrat financiare sipas rekomandimeve të KLSH-së.

Statusi: Zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Në fund të periudhave ushtrimore të viteve 2018, 2019 dhe 2020, kanë rezultuar detyrime të pa paguara ndaj të tretëve, ndërkohë që nuk janë përdorur të gjitha burimet financiare. Kjo praktikë e menaxhimit të fondeve është në kundërshtim me nenin 52- Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

19.1 Rekomandimi: Titullari i Autoriteti Kontraktor dhe Drejtoria e Financës dhe Menaxhim Buxhetit, të marrë masat për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit, të merren masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve kreditore, në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe të eliminohet praktikat që sjellin shtesë detyrimesh të prapambetura.

Nga auditimi rezultoi se:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, ka zbatuar mbajtjen e kontabilitetit duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit duke plotësuar edhe rekomandimet 13.1 dhe 15.1. Në vazhdimësi do të ndiqet zbatimi për rastet e reja.

Statusi: Zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, është konstatuar se 7 procedura me vlerë kontrate **125,071 mijë lekë**, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP, duke bërë që të kemi mos pjesëmarrje të OE në gara, duke ulur kështu numrin e pjesëmarrësve në procedura.

20.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kukës, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe e gjithë proceduara e ndjekur të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes.

Nga auditimi rezultoi se:

Bashkia Kukës për çdo rast të procedurave të zhvilluara ka ngritur grup pune me specialistë të fushës, konkretisht si vijon:

- Urdhri nr.148, datë 09.02.2022 “ Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kancelarie”.
- Urdhri nr.400, datë 13.05.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i godinës së kopshtit nr.2, lagje nr. 3.

- Urdhri nr. 502, datë 31.05.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i bazamenteve të shtëpizave dhe shtëpizave prej druri, rrugëve të brendshme , punime ndriçimi, ujësjellës dhe kanalizimeve në Parkun e Aventurave “
- Urdhri nr.149, datë 09.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Investim për pyllëzim të ekonomisë pyjore”.
- Urdhri nr. 526, datë 15.06.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi”.
- Urdhri nr. 502, datë 31.05.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i murit rrethues të fushës stërvitore Ilirjan Thaci”.
- Urdhri nr. 128, datë 04.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim, asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Nange”
- Urdhri nr. 172, datë 15.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”.
- Urdhri nr. 147, datë 09.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje goma për automjetet”.
- Urdhri nr. 146, datë 09.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje automjete për pastrimin (dy kamioncina dhe një vetëshkarkuese”.
- Urdhri nr. 376, datë 06.05.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës qendër Shtiqen – Aeroport”.
- Urdhri nr. 524, datë 15.06.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i bazamenteve të shtëpizave dhe shtëpizave prej druri, rrugëve të brendshme, punime ndriçimi, ujësjellës dhe kanalizimeve në Parkun e Aventurave”.
- Urdhri nr. 525, datë 15.06.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale ndërtimi”.

Nxjerrja e urdhrave është vetëm hapi i parë për fillimin e procedurës, ndërkohë që rekomandimi i KLSH ka të përcaktuar edhe hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe e gjithë procedura e ndjekur të dokumentohet.

Statusi: Në proces zbatimi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se për procedurën e prokurimit “Blerje karburanti për Bashkinë Kukës”, ka mangësi të theksuara bashkëpunim dhe bashkërendimi, midis strukturave përkatëse, për kryerjen e procedurave dhe ndjekjen e hapave për planifikimin e fondeve referuar nevojave. Nuk ka patur bashkëpunim si brenda Bashkisë Kukës, po ashtu edhe me Njësitë Administrative, përse i përket mbledhjes së kërkesave reale nga strukturat, sektorët

përkatës edhe të NJA, përpunimin e tyre në nivel institucional, me qëllim planifikimin e burimeve të financimit, nëpërmjet planifikimit të tyre në PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit.

21.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Kukës, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, me qëllim përmirësimin e procedurave dhe procesit të planifikimit të buxhetit, si atë afatmesëm dhe buxheteve vjetore, duhet të marrë masa që në të ardhmen të nxjerrë urdhra/udhëzime të brendshme, për përcaktimin e hartimin e PBA dhe planeve vjetore të buxhetit, duke nisur me përllogaritjen sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse të nevojave, për çdo veprimtari të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, në nivel programi dhe për çdo zë të shpenzimeve buxhetore.

Nga auditimi rezultoi se:

Nga Titullari i Bashkisë Kukës është përgatitur Udhëzimi i Brendshëm Nr.580/1, datë 30.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022 – 2024”.

Statusi: Zbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Me qëllim disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, si dhe eliminimin e rasteve të fillimit të procedurave të prokurimit publik, pa patur fonde në dispozicion është kërkuar që Njësia e Prokurimit, duhet të posedojë përpara fillimit të procedurës së prokurimit “Kërkesën për marrje angazhimi”. Nga auditimi rezultoi se në për procedurën e prokurimit “Blerje karburanti për Bashkinë Kukës” nuk ndodhej në dosjet përkatëse “Kërkesa për marrje angazhimi” dhe konfirmimi i saj nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 70.

22.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, Njësia e Prokurimit dhe Nëpunësi Zbatues me qëllim eliminimin e mundësive, për marrje angazhimesh pa fonde në dispozicion, të marrin masa të menjëhershme që: NJP, në fillimin e çdo procedure prokurimi, duhet së pari ta mbështesë në Kërkesën për marrje angazhimi, nga struktura përkatëse dhe konfirmimin e saj nga NZ dhe NA.

Nga auditimi rezultoi se:

Titullari i Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit dhe Nëpunësi Zbatues ka siguruar zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, në fillimin të çdo procedure prokurimi, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018, “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” neni 39, 49, 153, 154.

Statusi: Në proces zbatimi

23. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit u analizua përllogaritja e vlerës limit të kontratës në të cilën ne si KLSH na rezulton se nga Njësia e Prokurimit është mbajtur proces verbal nr.1 datë 07.02.2019 “Për përllogaritjen e fondi limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “Blerje karburanti për Bashkinë Kukës”, nënshkruar nga të gjithë anëtarët e NJP. Bashkëlidhur është procesverbal Nr. 191/1 Prot, datë 23.01.2019 “Për përcaktimin e normativave të karburantit për mjetet, makineritë dhe pajisjet në pronësi të Bashkisë Kukës”.

Në proces verbal citohet se nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në përllogaritjen e Fondit Limit janë marrë parasysh kërkesat e viteve të mëparshme 2018 dhe 2017. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e inventarizuar rezulton se mungojnë këto kërkesa. Përllogaritja e fondit limit është bërë duke u bazuar në përfundimet e komisionit të ngritur me Urdhër nr. 11, datë 10.01.2018 dhe Urdhër nr. 42, datë 09.02.2017 për normativat e harxhimit të karburantit për automjetet në pronësi të Bashkisë Kukës. Në argumentet e komisionit si edhe në arsyetimin e Njësia e Prokurimit në proces-verbal është vlerësuar Fondit Limit bazuar në normativën e harxhimit të karburantit të 24 automjeteve në pronësi dhe përdorim të Bashkisë Kukës. Por

parashtrimi i normave të konsumit nuk është sasia reale e nevojave të cilat do i nevojiten Njësia e Prokurimit të përlogarisë vlerën e fondit limit.

Nga verifikimi në Bilancin Kontabël dhe Regjistrin e Aktiveve, rezulton se 12 prej 24 automjeteve të listuar në proces-verbal, nuk janë në pronësi të Bashkisë Kukës dhe janë pa leje qarkullimi në momentin e zhvillimit të kësaj procedure. Në përbërje të proces-verbalit të përlogaritjes së Fondit Limit, si edhe shqyrtimi i kërkesave të ardhura nga njësitë e tjera shpenzuese rezulton se, kriteri ose metoda e vetme e përlogaritjes së Fondit Limit është vetëm prej normave të konsumit të automjeteve, të cilat nuk shprehin nevoja të qarta dhe reale sipas planeve dhe programeve të punës, si e tillë nuk shprehin qartësisht konsumin real të tyre për vitet e mëparshme, nga ku duhet të merret si reference për zhvillimin e procedurës aktuale “Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

23.1 Rekomandim: Titullari i AK, dhe përgjegjësi i NJP të marrin masa për caktimin e modalitetit mbi të cilin do të bazohet hartimi i fondit limit të kësaj procedure, bazuar në konsumin e mjeteve në pronësi të Bashkisë Kukës, me qëllim përcaktimin e tij sa më afër realitetit.

Nga auditimi rezultoi se:

Në fillim të çdo viti është ngritur komisioni përgjegjës për përcaktimin e normativave të konsumit për makineritë që janë pjesë e inventarit të Bashkisë Kukës. Përlogaritja e fondit limit është realizuar edhe në bazë të testimit të tregut. Të gjithë automjetet furnizohen me kartë elektronike e si rrjedhojë janë të regjistruara.

Statusi: Zbatuar

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit në Bashkinë Kukës rezulton se:

- Nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e 22 rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën 58,454,318 lekë ndërsa është në proces vetëm zbatimi i 1 rekomandimi për arkëtimin e vlerës 606,323 lekë;

- Nga 11 rekomandimet që në auditimin e zbatimit të rekomandimeve janë vlerësuar si në proces zbatimi janë zbatuar vetëm 2 dhe mbeten ende në proces zbatimi 9 rekomandimet e tjera;

- 2 rekomandime organizative nuk janë zbatuar ende.

Ndërsa lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit në Bashkinë Kukës-ish komunat rezulton se:

- Nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e 18 rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën prej 13,968,716 lekë;

- Nuk është zbatuar masa organizative lidhur me zberthimin e vlerës prej 12,472,892 lekë nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës për çdo objekt në zbatim të kërkesave të standardit për transferimin e vlerës të çdo objekti të cilit i ka përfunduar projekti;

- Nuk është kryer auditim tematik nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Njësinë Administrative Arrën (ish Komuna Arrën).

24.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë Juridike si dhe në Këshillin Bashkiak mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH të dërguara me shkresat nr. 1005/58 Prot, datë 20.12.2018 për Bashkinë Kukës dhe shkresën nr. 1005/59 Prot, datë 20.12.2018 për ish-Komunat (sot Njësitë Administrative), si dhe të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave përkatës dhe hartimin e planeve specifike të punës për:

- Zbatimin e 22 rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën 58,454,318 lekë;

- Zbatimin e 9 rekomandimeve organizative që janë nxjerrë urdhrat përkatës, por rezultojnë ende në proces zbatimi;
- Zbatimin e 2 rekomandimeve organizative që ende nuk janë zbatuar;
- Zbatimin e 18 rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën prej 13,968,716 lekë për Njësitë Administrative.

Nga auditimi rezultoi se:

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka arkëtuar vetëm vlerën 606,323 lekë, e cila është e zbritur nga vlera 58,454,318 lekë për 22 rekomandimet. Pjesa tjetër e rekomandimeve nuk është arritur të zbatohet.

Statusi: Pa zbatuar

25. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 2018-2020, IMT ka vendosur në total 66 gjoba me vlerë 285,430,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar në mënyrë vullnetare vetëm 8 gjoba me vlerë 1,400,000 lekë dhe nuk janë arkëtuar 58 gjoba me vlerë **284,030,000 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës. Niveli i arkëtimit të gjobave për vitin 2018 është 50% e vlerës, për vitin 2019 është 3.7% e vlerës dhe për vitin 2020 është 0.07% e vlerës. Për gjobat e pa paguara IMT nuk ka ndërmarrë asnjë hap ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e tyre duke mos dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrit e Ekzekutimit për secilën gjobë, rrjedhimisht nuk ka ndjekur as hapat e tjera të parashikuar në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar, neni 9, neni 22, neni 24, neni 31, pika 5si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë.

25.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike dhe TIK, të kërkojnë në gjykatë, shndërrimin e 58 vendimeve të kundërvajtjes në "titull ekzekutiv" si dhe të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitet 2018-2020 në vlerën **284,030,000 lekë**.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për të bërë kontabilizimin e menjëhershëm të gjobave të vendosura ndaj shkelësve të ligjit në përputhje me kërkesat dhe rregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të kontabilitetit.

Nga auditimi rezultoi se:

IMTV Kukës ka ndjekur të gjitha hapat ligjore për të realizuar produktin final të vjeljes dhe arkëtimit të gjobave të vëna. Konkretisht, për të gjitha gjobat e vëna si vijon:

- U janë dërguar Njoftimet e Akteve të Procesverbaleve të Konstatimit; Pezullimit; dhe Vendimeve të Gjobave përkatëse subjekteve kundërvajtës.
- U është dërguar Njoftimi për pagesën vullnetare të gjobës, pasi nuk janë paraqitur vullnetarisht për të kryer pagesën. IMTV Kukës i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative, që për Rrethin e Kukësit korrespondon të përfshihet në juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së parë Administrative të Shkodrës, me shkresën me lëndë: 'Kërkesë për Lëshim Urdhri Ekzekutivi'. Sqarojmë që gjoba në vetvete përbën Titull Ekzekutiv, porse ligjvënësi nuk e ka bërë automatikisht të ekzekutueshme, duke e bërë obligim ligjor kërkimin e lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit nga Gjykata kompetente.
- Është punuar me të gjitha rastet e gjobave të vëna, ku çdo rast është vënë në lëvizje dhe është aktualisht në proces, edhe pse realizimi i vjeljes së pagesës është i ulët.
- Për 8 raste Gjykata ka dalë me Vendim për Lëshim Urdhër Ekzekutivi, të cilat menjëherë janë dërguar te Përmbaruesi Gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Kukës. Dy prej tyre janë nënshkruar marrëveshjet e ekzekutimit dhe janë bërë derdhjet kësteve të para për pagimin e gjobës dhe pjesa tjetër janë te përmbaruesi në proces për marrëveshjen e pagesës. Gjithashtu,

falë këmbënguljes dhe bashkëpunimit të mirë të Inspektorëve të IMT me disa prej rasteve të subjekteve kundërvajtës, është arritur pagimi i shumë gjobave në mënyrë vullnetare.

Statusi: Në proces zbatimi

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të aktivitetit të IMT-së u konstatuan parregullsi dhe mos zbatim i përcaktimeve ligjore si më poshtë:

- Kryeinspektori i IMT nuk ka miratuar planet mujore të punës mbi bazë të të cilave do të kryejë kontrolle në territorin administrativ të bashkisë në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 1/b/ii. Për periudhën 2018-2020 planet e punës janë miratuar vetëm për muajt shtator-tetor 2019.

- Kryeinspektori nuk ka miratuar akte kontrolli për kontrollet që duhet të ushtrojë në objektet e pajisura me leje ndërtimi.

- IMT nuk ka dokumentuar procesin e ekzekutimit të vendimeve të prishjes së objekteve të ndërtuara pa leje, nga 35 vendime prishje është dokumentuar ekzekutimi vetëm për 2 vendime.

- Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacion dhe nuk ka raportuar në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e IMT-së, mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm etj, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5, pika f.

26.1 Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT-së të marrë masa për:

- Të miratuar rregullisht planet mujore të punës për kontrollet që planifikohen të kryhen brenda muajit;

- Të miratojë rregullisht aktet e kontrollit për kontrollet që planifikon të ushtrojë në objektet e pajisura me leje ndërtimi;

- Të raportojë në mënyrë periodike mbi zhvillimin e aktivitetit të IMT-së në IKMT;

- Të administrojë aktivitetin e IMT-së duke dokumentuar proceset e punës si ekzekutimi i vendimeve të prishjes krijimi i dosjeve për ndjekjen e hapave ligjorë për arkëtimin e gjobave etj.

Nga auditimi rezultoi se:

IMTV Kukës ka vazhduar me miratimet e planeve mujore dhe vjetore; aktet e kontrolleve; raportimet e aktiviteteve të IMT-së në IKMT (të pasqyruara në korrespondencë); si edhe raportimin dhe dokumentimin e të gjitha lëvizjeve dhe hapave të marra nga IMTV, në Regjistrin e Brendshëm.

Statusi: Zbatuar

27. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i proces verbaleve të konstatimit të kundërvajtjes për vitin 2018-2020, rezultojnë 16 raste të konstatuara për kryerje punimesh pa leje, ndaj të cilave nuk është marrë masa për vendosjen e gjobave dhe 13 raste kur gjoba nuk është vendosur në masën e duhur, duke sjellë mungesë të ardhurash në Bashkinë Kukës për vitet 2018-2020 në vlerën 16,500,000 lekë.

27.1 Rekomandimi: IMT të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar.

Nga auditimi rezultoi se:

IMTV Kukës ka zbatuar rekomandimin e mësipërm në të gjitha gjobat e reja që janë vënë pas Auditimit të KLSH, duke vlerësuar me kujdes kundërvajtjen e konstatuar në raport me masën e arsyeshme të gjobës së vënë.

Statusi: Zbatuar

Masa shpërblim dëmi:

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Njesisë Publike (Bashkia Kukës), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Njësia Zbatues të ndiqet procesi me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **41,806,125 lekë pa Tvsh** për 5 raste, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në procesin inventarizues së mallit “Karburant” në njësinë e magazinës në Bashkinë Kukës, Titullari i AK nuk ka dhënë Urdhër për ngritjen e komisionit të inventarizimit të mallit, i cili pranon mallin sipas specifikimeve të kontratës së nënshkruar.

- Grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga magazina për të verifikuar procedurën e daljes së mallit dhe vuri re se, në përzgjedhjet rastësore brenda periudhës së kontratës së sipërpërmendur, fletë-daljet nuk shoqëroheshin me asnjë dokumentacion justifikues si kërkesë të njësisë shpenzuese, urdhër dhe program pune për konsumin e karburantit, pa fletë udhëtimi, pa autorizim nga titullari për lëvizjen e automjetit dhe autorizim për shoferët përkatës, në vlerat dhe me përgjegjësit.

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **14,537,823 lekë pa TVSH** nga A.P. në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe P.TH., në cilësinë e Shef i Tatim Taksave, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues.

Nga auditimi rezultoi se:

Kanë dalë urdhrat e zhdëmtimit për z. A.P. në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike me shkresën nr. 1207 Prot., datë 03.03.2022 dhe për z. P.TH., në cilësinë e Shef i Tatim Taksave me shkresën nr. 1220 Prot., datë 03.03.2022. Nuk është arkëtuar vlera prej 14,537,823 lekë pa TVSH.

Statusi: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt: “Blerje mjetesh dhe makinerish për mirëmbajtjen e rrugëve”, Bashkia Kukës, me vlerë të kontratës (me TVSH) 36,936,000 lekë, fituar nga OE “T.” SHPK, rezultuan diferenca të dukshme në mjete & makineri që janë deklaruar nga OE i shpallur fitues nga zbatuesi i kontratës, për zërat e makinerive & pajisje: 1. Fadromë; 2. Kamionë multifunksional; 3. Kamion Vetëshkarkues e 4. Traktor me zinxhirë. Nga auditimi i dokumentacionit të makinerive dhe këqyrja në vend e tyre në terren rezultoi se asnjë prej tyre (makinerive të sipërcituar nuk është në përputhje me nënpikat 5, 6 e Pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” dhe “Specifikimet Teknike”. Kontraktori “T.” SHPK nuk ka sjellë asnjë nga makineritë sipas përcaktimeve në nenet 8 e 9 të Shtojca 16 “Kushtet e Përgjithshme” të DT dhe nenet 5, 9 11 e 14 të kontratës të lidhur me nr. 67 Prot., datë 02.09.2020. Vlera ekonomike e mjete & makineri është **26,500,000 lekë pa TVSH** vlerë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Kukës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

deklaratën për makineritë Administratori i OE “T.” SHPK, i shpallur fitues

- nënpikat 5, 6 e Pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” dhe Specifikimet Teknike.

- nenet 8 e 9 Shtojca 16 “Kushtet e Përgjithshme” të DT.
- nenet 5, 9 11 e 14 të kontratës me nr. 67 prot., datë 02.09.2020. kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 57 prot datë 17.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “Ti” SHPK.

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **26,500,000 lekë pa TVSH** nga OE “T.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 67 prot., datë 02.09.2020 57, me objekt: “Blerje mjetesh dhe makinerish për mirëmbajtjen e rrugëve”, Bashkia Kukës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore, si pasojë e likuidimit të makinerive & pajisje jashtë kushteve të DT, specifikimeve teknike e kontratës.

Nga auditimi rezultoi se:

- Bashkia Kukës pas auditimit të fundit të KLSH ka ngritur një grup pune i cili ka kontrolluar mjetet e marra në dorëzim referuar kontratës së lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “T.” SHPK. Në verifikimin e bërë grupi i punës ka konstatuar se mjetet kanë patur të meta duke sjellë mospërmbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore nga ana e OE “T... SHPK”.
 - Referuar këtij konstatimi Bashkia Kukës me shkresën 5370 Prot. datë 23.11.2021 i ka kërkuar OE “T.” SHPK të marrë masa për të plotësuar mangësitë e konstatuara në mjetet e marra në dorëzim në të kundërt do të marrë masa për zgjidhjen e kontratës dhe nuk do të likuidojë pjesën e mbetur të saj. Kjo kërkesë nuk ka marrë përgjigje nga ana e OE.
 - Me shkresën nr. 4335 Prot. datë 27.06.2022 Bashkia Kukës i është drejtuar përsëri OE për të marrë masat për plotësimin e mangësive të konstatuara në mjete.
 - Shoqëria “T.” SHPK me shkresën nr. 15 Prot. datë 01.08.2022 i ka kthyer përgjigje Bashkisë Kukës ku raporton se ka marrë masat për plotësimin e mangësive që kishin rezultuar në mjetet e dorëzuara.
 - Grupi i punës i ngritur nga Bashkia Kukës ka mbajtur proces verbalin nr. 4855/1 Prot. datë 02.08.2022 për marrjen në dorëzim të mjeteve dhe makinerive të dorëzuara nga Shoqëria “T.” SHPK. Komisioni ka konstatuar se parametrat e mjeteve dhe makinerive janë në përputhje me kërkesat e bëra nga Bashkia Kukës. Proces verbali është i shoqëruar me lejet e qarkullimit të mjeteve që japin detaje për parametrat e tyre.
- Gjithashtu, Bashkia Kukës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, ka pezulluar likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata.

Statusi:Në proces

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Bashkia Kukës me shkresën nr. 4531/8 Prot, datë 24.08.2022 është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 571/5 Prot, datë 25.08.2022 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në auditimin e fundit KLSH ka lënë rekomandimin si vijon: “Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 26,500,000 lekë pa TVSH nga operatori ekonomik “T. SHPK”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 67 Prot, datë 02.09.2020, me objekt: “Blerje mjetesh dhe makinerish për mirëmbajtjen e rrugëve” vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore, si pasojë e likuidimit të makinerive dhe pajisjeve jashtë kushteve të dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kontratës”.

Nisur nga rekomandimet e lëna nga KLSH, Bashkia Kukës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e tyre.

Me Shkresën nr. 5370 Prot datë 23.11.2021 Bashkia Kukës i është drejtuar me kërkesë për ndreqje të të metave të mjeteve kontraktorit "T." SHPK. "...Nga verifikimi i raportit të grupit të punës datë 22.11.2021, u konstatua se mjetet kanë patur të meta të mëdha të cilat përbëjnë mospërbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore nga ana e kontraktorit "T." SHPK. Bazuar në nenin 722, pika 2, të Kodit Civil, ku përcaktohet: "Në rastin kur dorëzimi i sendeve me të meta perben një mospërbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore, blerësi ka të drejtë të kërkojë: 1. në momentin e denoncimit, të parashikuar në nenin 717 të këtij Kodi ose brenda një periudhe kohë të arsyeshme nga ai denoncim, dorëzimin e sendeve si shtesë apo zëvendësim; 2. eliminimin e të metave me anë të ndreqjes, kur kjo është e arsyeshme të merret parasysh në gjithë rrethanat konkrete. Kërkesa për ndreqjen duhet të bëhet në momentin e denoncimit të parashikuar në nenin 717 apo brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga ky denoncim; 3. të kërkojë uljen e çmimit; 4 të deklarojë zgjidhjen e kontratës. Përsa me sipër, kërkojmë:

a) Eliminimin e të metave të mjeteve me anë të zëvendësimit të tyre brenda afatit kalendarik 30 ditë, nga data e marrjes së kësaj shkrese, duke dorëzuar mjete në përputhje me specifikimet teknike bashkëngjitur kësaj shkrese;

b) Në rast se do të dështoni në ndreqjen e të metave brenda afatit të dhënë më sipër, jeni të detyruar të tërhiqni mjetet përkatëse dhe të paguani në llogarinë bankare shumat e paguara nga Bashkia Kukës në llogarinë tuaj.

e) Gjithashtu, në rast se do të dështoni në përmbushjen e kërkesave tona, ju bëjmë me dije se autoriteti kontraktor nuk do t'iu bëjë asnjë pagesë tjetër, do t'iu dërgoj njoftim për zgjidhje të kontratës së nënshkruar midis palëve, kthimin e shumës së paguar nga ana jonë në llogarinë tuaj dhe dëmshpërblimin përkatës".

Duke qënë se nuk morëm përgjigje brenda afateve kohore, me shkresën nr. 5543 Prot. datë 06.12.2021 dërguam kërkesë të përsëritur, Kontraktorit "T." SHPK . Me shkresën nr. 4335 Prot datë 27.06.2022, Bashkia Kukës dërgoi përsëri kërkesë Kontraktorit "T." SHPK për ndreqjen e të metave të mjeteve.

Shoqëria "T." SHPK me shkresën nr. 15 Prot. datë 01.08.2022, ka njoftuar për marrjen e masave të menjehershme dhe korrigjimin e elementeve teknike, faktuar me dokumentacionin justifikues të kryerjes së këtyre riparimeve (Aneksi 4). Kontraktori "T." SHPK ka marrë përsipër zëvendësimin e të metave sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe sipas kontratës. Gjithashtu Kontraktori "T." SHPK, ka dorëzuar dokumentacionin e saktë dhe në përputhje të plotë me kushtet dhe specifikimet e kontratës për të katër automjetet, si më poshtë:

1. Leje Qarkullimi nr.serial 0000000098946 Targa AB307CH kamion

2. Leje Qarkullimi nr.serial 0000000098945 Targa AB320CH kamion

3. Leje Qarkullimi nr.serial 0000000098948 Targa AB316CH kamion

4. Leje Qarkullimi nr.serial 0000000098947 Targa AB302CH kamion

Korrigjimi i elementeve teknike dhe dokumentacioni përkatës, është marrë në dorëzim me anë të procesverbalit datë 02.08.2022 nga Komisioni i Marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 622/1, datë 02.08.2022, i cili i gjeti ato në përputhje me kushtet e kontratës. Gjithashtu, dokumentacioni/lejet e qarkullimit të mjeteve janë bashkëngjitur kësaj shkrese.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së:

Grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur me observacion nga Bashkia Kukës ku rezultoi se:

- Bashkia Kukës pas auditimit të fundit të KLSH ka ngritur një grup pune i cili ka kontrolluar mjetet e marra në dorëzim referuar kontratës së lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “T. SHPK”. Në verifikimin e bërë grupi i punës ka konstatuar se mjetet kanë patur të meta duke sjellë mospërbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore nga ana e OE “T. SHPK”.
- Referuar këtij konstatimi Bashkia Kukës me shkresën 5370 Prot. datë 23.11.2021 i ka kërkuar OE “T. SHPK” të marrë masa për të plotësuar mangësitë e konstatuara në mjetet e marra në dorëzim në të kundërt do të marrë masa për zgjidhjen e kontratës dhe nuk do të likuidojë pjesën e mbetur të saj. Kjo kërkesë nuk ka marrë përgjigje nga ana e OE.
- Me shkresën nr. 4335 Prot. datë 27.06.2022 Bashkia Kukës i është drejtuar përsëri OE për të marrë masat për plotësimin e mangësive të konstatuara në mjete.
- Shoqëria “T. SHPK” me shkresën nr. 15 Prot. datë 01.08.2022 i ka kthyer përgjigje Bashkisë Kukës ku raporton se ka marrë masat për plotësimin e mangësive që kishin rezultuar në mjetet e dorëzuara.
- Grupi i punës i ngritur nga Bashkia Kukës ka mbajtur proces verbalin nr. 4855/1 Prot. datë 02.08.2022 për marrjen në dorëzim të mjeteve dhe makinerive të dorëzuara nga Shoqëria “T. SHPK”. Komisioni ka konstatuar se parametrat e mjeteve dhe makinerive janë në përputhje me kërkesat e bëra nga Bashkia Kukës. Proces verbali është i shoqëruar me lejet e qarkullimit të mjeteve që japin detaje për parametrat e tyre.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Kukës rezulton se masat e marra në zbatim të rekomandimit të KLSH-së janë masa alternative dhe nuk janë plotësisht në përmushje të rekomandimit të lënë nga KLSH në Vendimin nr. 178, datë 20.10.2021, të Kryetarit të KLSH-së. Nisur nga fakti që qëllimi i masave të marra ka qenë që mjetet dhe makineritë të plotësojnë parametrat e kërkuara nga Bashkia Kukës grupi i auditimit e klasifikon rekomandimin të plotësuar pjesërisht dhe në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Mamëz”, Bashkia Kukës, me vlerë të kontratës (me TVSH) 24,508,443 lekë, të kontratuar me “N.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **388,602 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 57 Prot datë 17.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe kontraktorit “N.” SHPK.

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **388,602 lekë pa TVSH** nga kontraktori “N.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 57 Prot datë 17.09.2018, me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Mamëz”, Bashkia Kukës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga auditimi rezultoi se:

Bazuar në rekomandimin e lënë nga auditimi i fundit i KLSH-së, Bashkia Kukës ka arkëtuar vlerën prej **388,602 lekë pa TVSH** nga kontraktori “N.” SHPK.

Statusi: Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Restaurim i lapidarit dhe varrezave të Dëshmorëve të Atdheut”, Bashkia Kukës, me vlerë të kontratës (me TVSH) 19,658,928 lekë, fituar nga BOE “L.-F. Company” SHPK & “K.A.E.XH” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **221,400 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 60 prot

datë 05.08.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe kontraktorit “L...-F... Company” SHPK & “K.A.E.XH” SHPK.

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **221,400 lekë** pa TVSH nga kontraktori “L.-F. Company” SHPK & “K.A.E.XH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 60 Prot. datë 05.08.2020, me objekt “Restaurim i lapidarit dhe varrezave të Dëshmorëve të Atdheut”, Bashkia Kukës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga auditimi rezultoi se:

Bazuar në rekomandimin e lënë nga auditimi i fundit i KLSH-së, Bashkia Kukës ka arkëtuar vlerën prej **221,400 lekë** nga kontraktori “L.-F. Company” SHPK & “K.A.E.XH” SHPK.

Statusi: Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme Shtiçen”, Bashkia Kukës, me vlerë të kontratës (me TVSH) 20,945,920 lekë, fituar nga OE “N.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **158,300 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 52 Prot datë 10.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “N.” SHPK.

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **158,300 lekë** pa TVSH nga kontraktori “N.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 52 prot datë 10.09.2018, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme Shtiçen”, Bashkia Kukës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga auditimi rezultoi se:

Bazuar në rekomandimin e lënë nga auditimi i fundit i KLSH-së, Bashkia Kukës ka arkëtuar vlerën prej **158,300 lekë** nga kontraktori “N.” SHPK.

Statusi: Zbatuar

Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 7 procedurave të prokurimit publik nga të cilat janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP në 5 procedura me vlerë kontrate **102,196 mijë lekë** pa TVSH, ku në një rast në objektivin “Restaurim i lapidarit dhe varrezave të dëshmorëve” nga hartuesi i analizave teknike të çmimeve, është përlllogaritur gabim FL dhe në 6 raste nga KVO janë kualifikuar padrejtësisht OE/BOE me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke mos anuluar procedurën dhe zhvilluar procedurë të re, me kriterë më të favorshme për rritjen e numrit të pjesëmarrësve në procedurë, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike pa economicitet, eficientë dhe efektivitet për vlerën prej **102,198 mijë lekë pa TVSH**, respektivisht:

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Shtiçen”, Bashkia Kukës me fond limit 17,843 mijë lekë TVSH, me fitues OE “O.” SHPK me vlerë të ofertës 17,454,933 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **17,454,933 lekë pa TVSH**.

1.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9 vjeçare Mamëz”, Bashkia Kukës me fond limit 20,524 mijë lekë TVSH, me fitues OE “N.” SHPK me vlerë të ofertës 20,423,702 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar

dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **20,423,702 lekë pa TVSH**.

1.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së fshatit Fshat”, me fond limit **18,447,000 lekë pa TVSH**, me fitues OE “O.” SHPK me vlerë të ofertës 17,155,882 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **17,155,882lekë pa TVSH**.

1.4 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Restaurim i lapidarit dhe varrezave të dëshmorëve” Bashkia Kukës, me fond limit 16,600 mijë lekë pa TVSH, me fitues B. L. F. Company” SHPK & “K.” SHPK me ofertë 16,383,440 mijë lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **16,383,440 lekë pa TVSH**.

Nga auditimi i analizës së çmimit të zërit të punës “Ndërtim varre të reja me element guri dekorativ”, me njësi “copë”, konstatohet se është nën zëri “Korniza guri për varrin me 5 cm trashësi x 30 cm gjerësi” dhe kërkohen 6 ml (ose 1.8 m² pllakë guri me trashësi 5 cm), me vlerë 24,000 lekë. Ky nën zë, nisur nga përmasat, duhet të ishte marrë në njësinë “m²”. Bazuar në Manualin e çmimeve nr. 2, zëri i punës “Veshje fasade me pllaka guri” me analizë 2.355/b, konstatohet se nën zëri “pllaka guri” ka çmimin 1800 lekë/m². Pra, në analizën e hartuar, nën zëri duhet të kishte vlerën 3240 lekë (1800 lekë/m² x 1.8 m²), ose 20,760 lekë më pak për një varrezë. Nisur nga fakti që ka 143 varreza, fondi limit do të ishte **2,968,680 lekë më pak** se fondi limit i shpallur në tender.

1.5 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje mjete dhe makinerish për mirëmbajtjen e rrugëve”, Bashkia Kukës me fond limit 30,900 mijë lekë, me fitues OE “T.” SHPK me ofertë 30,780,000 mijë lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **30,780,000 lekë pa TVSH**.

1.1(1-5) Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **102,198 mijë lekëpa TVSH**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Nga auditimi rezultoi se:

Në çdo komision vlerësimi është caktuar të paktën një ekspert i fushës, i cili kontrollon dhe vlerëson në mënyrë profesionale sidomos kriteret e veçanta që lidhen përpjesëtimisht me një profesion të caktuar (inxhinier, ekonomist dhe profesionistë të tjerë sipas rastit). Në përcaktimin e kriterëve njësia e prokurimit bazohet në të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, si dhe zbatohen të gjitha rekomandimet e Njësisë së Koordinimit të APP.

Statusi: Në proces zbatimi

MASAT DISIPLINORE:

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara

në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Në mos marrjen së masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.

- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kukës** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Nga auditimi rezultoi se:

Në bazë të Urdhrit nr. 768, datë 13.12.2021 “Për ngritjen e komisionit disiplinor në shërbimin civil në institucionin e Bashkisë Kukës” dhe shkresës nr. 512 prot., datë 17.05.2022 “Propozim për dhënie masash administrative disa punonjësve”, ku është propozuar vendosja e masave administrative për 13 punonjës, por realisht kanë dalë gjashtë vendime për 6 punonjës. Respektivisht vendimet si vijon: Vendim nr. 112, datë 24.06.2022; Vendim nr.113, datë 24.06.2022; Vendim nr. 114, datë 24.06.2022; Vendim nr. 115, datë 24.06.2022; Vendim nr. 116, datë 24.06.2022; Vendim nr. 117, datë 24.06.2022.

Statusi: Zbatuar

Përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve

Lloji i rekomandimeve	Rekomandime të dhëna	Vlera	Rekomandime të pranuar						Pa pranuar
			Zbatuar plotësisht	Vlera	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar	Vlera	
Masa organizative	27		13		-	13	1		0
Masa shpërbllim dëmi	5	41,806,125	3	768,302	-	1	1	41,037,823	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	1		-		-	1	-		0
Masa disiplinore	6		6		-	-	-		0

Punoi: Grupi i auditimit

Në përfundim nga auditimi rezultoi se:

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Kukës me shkresën nr. 448/8 Prot., datë 20.10.2021, pra më datë 20.05.2022 janë bërë 6 muaj nga data e dërgimit. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se, nga Bashkia Kukës janë marrë disa masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Përkatësisht:

Masa Organizative

Janë dhënë 27 masa organizative nga të cilat janë zbatuar 13 masa (rekomandimi 3.1, 4.1, 5.1, 10.1, 13.1, 15.1, 17.1, 18.1, 19.1, 21.1, 23.1, 26.1, 27.1), janë në proces zbatimi 13 masa (rekomandimi 1.1, 2.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 11.1, 12.1, 14.1, 16.1, 20.1, 22.1, 25.1) dhe nuk është zbatuar 1 masë (rekomandimi 24.1).

Rekomandimi 24.1, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka arkëtuar vetëm vlerën 606,323 lekë, nga vlera 58,454,318 lekë dhe nuk është arkëtuar ende vlera 57,847,995 lekë.

Masa Shpërblim Dëmi

Janë dhënë 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 41,806,125 lekë nga të cilat janë zbatuar 3 masa (rekomandimet 3.1, 4.1, 5.1) duke arkëtuar vlerën 768,302 lekë dhe nuk është zbatuar 1 masë (rekomandimi 1.1) për vlerën 14, 537,823 lekë është në proces rekomandimi 2.1.

Rekomandimi 1.1: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **14,537,823 lekë pa TVSH** nga A.Pnë cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe P.TH, në cilësinë e Shef i Tatim Taksave, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues.

Rekomandimi 2.1: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **26,500,000 lekë pa TVSH** nga OE "T." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 67 prot., datë 02.09.2020 57, me objekt: "Blerje mjetesh dhe makinerish për mirëmbajtjen e rrugëve", Bashkia Kukës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore, si pasojë e likuidimit të makinerive & pajisje jashtë kushteve të DT, specifikimeve teknike e kontratës.

Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike

Është dhënë 1 rekomandim: "Kryetari i Bashkisë Kukës, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **102,198 mijë lekëpa TVSH**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës", i cili rezulton **në proces zbatimi**.

Masa Disiplinore

Rekomandimi është zbatuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Kukës z. S.GJ., Nën/Kryetari i Bashkisë z. G.GJ., Nën/Kryetarja e Bashkisë znj. M.O., Sekretari i Përgjithshëm z.D.K. dhe Drejtori i Financës z. M. I.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit të kryer në Bashkinë Kukës ka sjellë mungesë të ardhurash nga mos shpërblimi i dëmit.

Shkaku: Procesi është duke u ndjekur në rrugë ligjore për një pjesë të operatorëve dhe bashkim operatorësh, ndërsa për mbikëqyrësit e punimeve është bërë vetëm njoftim për arkëtimin e detyrimit.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi:Bashkia Kukës të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

Bashkia Kukës të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të arkëtojë vlerën e mbetur prej 57,847,995 lekë, përsa i takon zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të KLSH-së.
- Të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 14,537,823 lekë pa TVSH nga z. A.P., në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe z. P.Th., në cilësinë e Shefit i Tatim Taksave, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues.
- Të merren masa për ndjekjen e 15 rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe që gjithashtu janë trajtuar edhe në raportin përfundimtar të auditimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” rezultoi se:

- Nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës, konkretisht në fushat me risk siç janë prokurimet publike, zbatimi i buxhetit, mbledhja e taksave, etj.
- Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si, dhe eprori direkt i Bashkisë Kukës, për vitin 2021 nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.
- Për vitin 2021 në Bashkinë Kukës, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet eligit nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, pika 3.3.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kukës të merren masa për:

- Hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore;
- Krijimin e procedurave për delegimin e detyrave;
- Hartimin e gjurmëve standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Vendosijen e një sistemi elektronik të mirëfilltë unik të mbajtjes së kontabilitetit;
- Hartimin e mekanizmave të cilat t’i dedikohen ankesave për korrupsion;
- Vendosijen e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, rezulton se:

- Një auditues është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 183, datë 13.09.2019, duke qenë e pa pajisur me certifikatën e audituesit.

- Nuk është planifikuar dhe nuk është kryar auditim në fushat me risk si, në sektorin IMTV-së, sektori i taksave dhe tarifave vendore, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

- Në programet dhe në procesin e auditimit të NJAB nuk konstatohet ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, e cila sjellë shkallë të ulët të zbatimit të tyre nga subjektet e audituara. Për vitin 2021, nga 303 rekomandime të dhëna, janë zbatuar 16 rekomandime dhe janë pa zbatuar 287 rekomandime.

- Nuk është kërkuar nga auditimi i brendshëm që subjektet e audituara, pas marrjes së rekomandimeve të hartojnë planin për zbatimin e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kukës të marrë masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën në vazhdim të organizohet dhe të funksionojë me 3 punonjës të certifikuar, kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Mjenjëhërë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 është 193,912,437 lekë, krahasuar me vlerën në fillim të vitit ushtrimor prej 158,489,871 lekë, është rritur me 35,422,566 lekë, ose në masën prej 22%.

Edhe pse janë marrë masa të mira për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2021, konstatohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor për të gjithë periudhën e auditimit. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë detyrimet ndaj institucioneve të tjera buxhetore në vlerën 85,867,527 lekë dhe detyrimet për investime prej 45,071,088 lekë, të ndjekura nga detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 22,417,656 lekë, detyrime për mallra në vlerën 11,020,394 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 1,063,545 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 12,682,171 lekë, detyrime për mirëmbajtje në vlerën 6,465,584 lekë, detyrime për tatimin mbi të ardhurat në vlerën 1,274,221 lekë, të tjera 8,050,251 lekë.

Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Bashkia Kukës klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive mbi nivelin prej 25 për qind (> 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara. Bashkia është klasifikuar në kategorinë me vështirësi financiare dhe kjo tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin e dytë pasues, të muajit të përcaktuar në ligj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me

përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 56, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim:Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 7,043,241 lekë, nga e cila vlera 4,720,812 lekë përket 7 vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, ndërsa vlera 2,322,429 lekë për 2 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore. Vlera e pa likuiduar e vendimeve gjyqësore më datë 31.12.2021 referuar listave analitike që administron Bashkia Kukës është 7,864,084 lekë për 18 vendime.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësiave administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësiave administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në likuidimin e vendimeve gjyqësore, nuk ka respektuar radhën e likuidimit sipas përparësisë kohore, bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësi të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, të marrë masa që jo vetëm të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj, por edhe të hartojë grafikun e likuidimit të tyre, duke u bazuar në përparësinë e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:Vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2021 është 193,912,437 lekë, ndërsa vlera totale e detyrimeve të prapambetura sipas akt rakordimeve me thesarin është 108,044,910 lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihet vlera prej

85,867,527 lekë që i përket detyrimit për institucionet buxhetore. Gjithashtu, Bashkia Kukës nuk ka deklaruar në raportimin e bërë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë vlerën e plotë të vendimeve gjyqësore. Vlera e deklaruar është 1,063,545 lekë ndërsa vlera sipas listave analitike është 7,864,084 lekë. Një pjesë e vendimeve gjyqësore nuk janë delkaruar si detyrime sepse Bashkia Kukës ka nënshkruar marrëveshje për likuidimin me këste të detyrimit dhe një pjesë nuk janë regjistruar sepse janë paraqitur me vonë në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në raportimin që dërgon në MFE dhe në akt rakordimin me thesarin, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të të gjitha detyrimeve që kanë mbetur pa u likuiduar në fund të vitit, me qëllim identifikimin e vlerës reale të detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të pa likuiduara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave pavarësisht kërkesave që ka dërguar në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2021 nuk ka marrë informacion ose ai ka qenë jo i plotë. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAPPLL për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Gjatë hartimit të paketës fiskale 2023 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të audituara, pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës paraqitet në vlerën 2,370,800 lekë, ndërsa planifikimi i bërë nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për vitin 2021 është në vlerën 568,328 lekë. Diferenca në planifikim është 1,802,472 lekë. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, dhe VKB nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”. Gjithashtu rezulton se, Bashkia Kukës ka filluar punën për të saktësuar numrin e familjeve që kanë tokë bujqësore me AMTP si dhe kategoritë që përjashtohen nga pagesa e kësaj takse me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota për të llogaritur më pas saktësisht planifikimin e të ardhurave nga toka bujqësore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën

bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën 1,802,472 lekë.

Deri në Dhjetor 2022

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 "Disponibiliteti në thesar" nuk paraqet gjendjen e saktë në bilanc. Kjo llogari duhet të sistemohet për diferencën 102,907,074 lekë, ku nga 280,267,814 duhet të jetë 158,359,154 lekë. Llogaritë e klasës 5 nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP" pika 46/a, 49, 50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për sistemimin e llogarisë 520 "Disponibiliteti në thesar" në vlerën 158,359,154 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analitikëvetë llogarisë 202 "Studime dhe kërkime", konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të përkasin edhe objekteve të përfunduara, duke siguruar vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 5,611,778 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të kryejë veprimet e sistemimit për llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime" duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të regjistrimit dhe pajisjes me titull pronësie të aktiveve për llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe llogarinë 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" të paraqitur 0 lekë në bilanc, në kundërshtim me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr. 8/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP", pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" dhe zërin 210 "Toka, troje, terrene", duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Aktivet afatgjata materiale të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në vlerën 1,531,017,817 lekë janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Kukës nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Kukës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Për llogarinë 215 “Mjete transporti” rezulton se është aplikuar norma e amortizimit 20 % dhe jo 13.8%. Si rezultat kjo anomali ka sjellë që llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM” të mbivlerësohet me 1,759,884 lekë, pasi vlera e saj në pasqyrat financiare është 1,100,466,218 lekë, kur në fakt duhet të jetë 1,098,695,329 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”, respektivisht në vlerën 1,098,695,329 lekë për vitin 2021.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

13. Gjetje nga auditimi: Vlera e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk është e njëjtë me tepricën e llogarisë 520. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 10,607,978 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 10,607,978 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Kukës nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021 ka nënvlerësuar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 14,758,973 lekë për vitin 2021. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022, por me kompetencë vitin 2021, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me

14,758,973 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara 14,758,973 lekë për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësisimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. nr. 448/8 Prot., datë 20.10.2021, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 69-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit të KLSH, rezulton se:

- Nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës **57,847,995 lekë** të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së.

- Nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës **14,537,823 lekë pa TVSH** nga z. A.P. në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe z. P.Th., në cilësinë e Shefit të Tatim Taksave, për dëmin e shkaktuar nga procesi i inventarizimit dhe menaxhimit të mallit “Karburant”.

